

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5553
E enjte, 16 gusht 2018
çmimi 0.40 €

Ka vullnet politik për përfaqësimin e diasporës në Kuvendin e Kosovës



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

HASAN PRISHTINA E KA VENDIN ATY KU BASHKOHET KUFIRI DHE IDETË E KOMBIT SHQIPTAR F.13



Mehmet PRISHTINA

TEHU I DËSHPËRIMIT, DREJT FUNDIT F.13



Nga Musa SABEDINI

MURATI: KOSOVËS PO I PËRGATITET SKENARI MË I KEQ I MUNDSHËM F.6

EKONOMI

ULET KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE PËR 6.7 PËR QIND F.9

KRIZA E VALUTËS NË TURQI HËPËR HË NUK KA EFEKT NË KOSOVË F.8

SPORT

DALLKU QËNDRON TE PRISHTINA, VJEN EDHE MARJO MORINA F.16

BMW-ja NË SULM PËR AKSIONET E AUDISË TE BAYERNI F.16



FLET PËR "EPOKËN E RE" PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI F.4-5

Korrigjimi i kufirit shuan ëndrrën serbe për ndarje të Kosovës

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se korrigjimi i kufirit me Serbinë fundos ëndrrën serbe për ndarje apo bosnjëzim të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se ata që e kundërshtojnë këtë ide janë kamikazë të fuqishëm politikë. Shefi i shtetit është zotuar se për këtë çështje dhe për

marrëveshjen përfundimtare me Serbinë do ta thonë fjalën qytetarët e Kosovës nëpërmjet referendumit. Presidenti Thaçi ka theksuar se nuk do të lejojë askënd ta bllokojë arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, e cila, sipas tij, siguron të ardhme evropiane për shtetin e Kosovës. Ai e ka ftuar opozitën të bëhet

pjesë e dialogut pasi, sipas tij, ballafaqimi i argumenteve duhet të ndodhë në tavolinë. Presidenti ka thënë se nuk do të lejojë që Asociacioni i Komunave Serbe të ketë kompetenca ekzekutive. Thaçi ka shprehur optimizëm se një bazë e mirë e marrëveshjes me Serbinë do të arrihet në pranverë të vitit të ardhshëm

Jep dorëheqje prokurori që hetonte listat e veteranëve, dyshohet se u kërcënua



Prokurori Elez Blakaj, i cili ishte duke i hetuar dyshimet për keqpërdorime në listat e veteranëve të UÇK-së, më nuk do të jetë pjesë e sistemit prokurorial të Kosovës meqë ka dhënë dorëheqje nga pozita e prokurorit. Edhe pse nuk është konfirmuar zyrtarisht, Blakaj dyshohet të ketë dhënë dorëheqje për shkak të kërcënimeve për punën e tij. Drejtuesit e organeve të rendit kanë bërë me dije se nuk kanë informacione nëse Blakaj ka dhënë dorëheqje për shkak të kërcënimeve, megjithatë ata kanë kërkuar hetim të plotë të këtij rasti F.3

Brenda 22 muajsh Kosova me Spital të Kirurgjisë Peditrike



FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com


Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



Bushati: Shteti do t'i ndihmojë familjarët e dy djemve

TIRANË, 15 GUSHT - Tragjedia e Xhenovas i tronditi të gjithë, për më tepër kur u mësua se dy nga 39 jetët e humbura janë shqiptarë. Pas reagimeve nga kryeministri Edi Rama dhe kreu i opozitës, Lulzim Basha, për tragjedinë ka reaguar edhe ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati. Ministri Bushati u

shpreh ngushëllimet familjarëve të dy djemve shqiptarë dhe sqaron se Ambasada në Romë do t'u ofrojë atyre mbështetje. "Lajm i dhimbshëm humbja e jetës së dy të rinjve shqiptarë, Marjus Djerri dhe Admir Bokrina, në tragjedinë e Genovas. Në këto momente të trishtuara u

shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta familjarëve dhe të afërmeve të tyre. Ambasada shqiptare në Itali është në gatishmëri të plotë dhe u ofron mbështetjen dhe ndihmën e shtetit shqiptar familjarëve në këtë çast të rëndë për ta", ka shkruar Bushati në "Facebook".

Volker: Njohja e Kosovës nga Serbia i shërben gjithë Ballkanit

Ambasadori Kurt Volker, ish-përfaqësues i ShBA-së në NATO, thotë se tani është koha të përmyllet plotësisht procesi i njohjes së Kosovës dhe njohjes së plotë ndërkombëtare të pavarësisë së saj dhe thekson se i gjithë rajoni, përfshirë Serbinë, do të përfitonin nga mbyllja e këtij kapitulli



WASHINGTON, 15 GUSHT - Kanë kaluar 21 vjet që nga shpërthimi i konfliktit në Kosovë dhe tani është koha të përmyllet plotësisht procesi i njohjes së Kosovës dhe njohjes së plotë ndërkombëtare të pavarësisë së saj. Kështu shprehet ambasadori Kurt Volker, ish-përfaqësues i Amerikës në NATO, aktualisht i dërguar i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ukrainën, i cili thekson se i gjithë rajoni, përfshirë Serbinë, do të përfitonin nga mbyllja e këtij kapitulli. Volker i bëri komentet gjatë një diskutimi në "Zërin e Amerikës" mbi 10-vjetorin e ndërhyrjes ruse në Gjeorgji dhe aneksimin e rajoneve të Abkhazisë e Osetisë së Jugut. Ambasadori Volker e quan padrejtësi ndaj të gjithëve në Ballkan, në veçanti ndaj kosovarëve, që shteti i tyre ende nuk njihet nga Serbia dhe nga të gjithë anëtarët e BE-së. "Si rezultat, ata janë të bllokuar në marrëdhëniet me BE-në dhe nuk janë në gjendje të përfito-

jnë plotësisht nga shpallja shtet i pavarur", tha ai. Kjo situatë, thotë Volker, mban peng edhe Serbinë. Do të ishte në të mirë të popullit serb, të mbyllë këtë kapitull të dhimbshëm dhe të turpshëm, thotë diplomati amerikan. "Serbët duhet të ecin përpara. Gjëja më e mirë për Serbinë, për mendimin tim, është integrimi në Bashkimin Evropian. Nëse Kosova dhe Serbia e të tjerët në rajon arrijnë ta bëjnë këtë, do të shohim një rajon shumë më funksional në aspektin e marrëdhënieve etnike, në aspektin e statusit, të zhvillimit ekonomik dhe politikës", tha Volker. Diplomati sjell si shembull problemet me Bosnjën që ai thotë se janë pjesërisht të lidhura me statusin ende të hapur të Kosovës në Ballkan. "Duke zgjidhur çështjen e Kosovës shënohet një hap i madh përpara për Bosnjën. Nëse Kosova e Serbia arrijnë në një marrëveshje që mundëson paqe të qëndrueshme, që lejon njohje të ndërsjellë mes dy shteteve,

kjo do ta stabilizonte disi politikën në Serbi. Kosova do ta kishte të hapur rrugën përpara, ndërsa problemet e Bosnjës do të reduktoheshin në sfidat që lidhen realisht me këtë vend", tha Volkeri. Diskutimi në 10-vjetorin e ndërhyrjes ruse në Gjeorgji përfshin edhe ambicidet dhe strategjitë gjeopolitike të aleatëve të fuqishëm të vendeve ballkanike. Studiuesi Paul Saunders shprehet se mbështetja e Uashingtonit dhe Brukselit për shkëputjen e Kosovës nga Serbia u bë një ndër pikat e fërkimit mes

Moskës dhe Perëndimit. "Përkrahja që i dhanë Shtetet e Bashkuara dhe Evropa shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga Kosova u pa nga Rusia si një rast që mund të shërbejë si pararendës, megjithëse Amerika dhe aleatët evropianë nuk donin të shërbente si e tillë", tha Saunders. Ambasadori Volker e kundërshton argumentin e Moskës për ta shfrytëzuar rastin e Kosovës si paralele për shkëputjen e Krimesë në Ukrainë apo për Abkhazinë, Osetinë e Jugut në Gjeorgji. Ai përmend një përpjekje të

bashkënduar të faktorëve ndërkombëtarë, bazuar në marrëveshjen e rezoluta ndërkombëtare, mekanizma shumëpalësh, ndër të cilët bënte pjesë edhe Moska, që mundësuan ndalimin e konfliktit në Kosovë dhe njohjen e statusit të saj si shtet i pavarur. Rusia, thotë ai, është e vetme në përpjekjet e saj për t'i ndryshuar kufijtë në Gjeorgji dhe Ukrainë. Me gjithë përpjekjet e saj, askush nuk e ka njohur Krimesë dhe, 10 vjet pas ndërhyrjes, Abkhazia dhe Osetia e Jugut mbeten ende pa status ndërkombëtar.

Mirel: Ndarja e Kosovës bart rrezik për Maqedoninë

BRUKSEL, 15 GUSHT - Ish-sekretari i përgjithshëm i Drejtorisë për Zgjerim në Komisionin Evropian, Pjer Mirel, shprehi shqetësim të madh për shkak të deklaratave për ndarje të Kosovës dhe paralajmëron se skenari i tillë bartë rreziqe sigurie për Maqedoninë dhe rajonin. Njeriu i mëparshëm kryesor për Ballkanin Perëndimor thotë se është i habitur nga reagimi i vakët

i Komisionit Evropian pas deklaratave të Thaçit dhe Vuçiqit dhe konsideron se Brukseli duhet të paralajmërojë për rreziqet të cilat i bartë ndarja e mundshme e Kosovës. "Menjëherë mendohet në Republikën Srpska, por edhe komunitetin shqiptar në Maqedoni, pastaj kantonet kroate në Bosnjë të cilat mund të thonë se dëshirojnë me Kroacinë. Por, kjo shkon edhe më

larg: hungarezët në Sllovaki, mund të paramendojnë se edhe Rusia në Transistri do ta merrte këtë për shembull", thotë Mirel. Ai shprehet se pozicionet për integritetin territorial të Kosovës janë konstatuar që nga negociatat në Rambuje, por nuk e përjashton opsionin që retorika të jetë "taktikë negociuese" e palës serbe për ta shtyrë Kosovën për Asociacionin e Komunave Serbe.

Por, se kjo është taktikë jo e mirë dhe vetvetiu sjell rreziqe. "Nëse kjo nuk është taktikë negociuese dhe nëse është reale, ndërsa referendumi për emrin në Maqedoni nuk kalon, absolutisht ka rrezik. Shqiptarët në Maqedoni do të mund të thonë se nuk e kanë vendin në atë shtet. Në çdo rast do të inkurajohet ideja për ribërje të kufijve", tha Mirel.



Elez Blakaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK)

Jep dorëheqje prokurori që hetonte listat e veteranëve, dyshohet se u kërcënua

Prokurori Elez Blakaj, i cili ishte duke i hetuar dyshimet për keqpërdorime në listat e veteranëve të UÇK-së, më nuk do të jetë pjesë e sistemit prokurorial të Kosovës meqë ka dhënë dorëheqje nga pozita e prokurorit. Edhe pse nuk është konfirmuar zyrtarisht, Blakaj dyshohet të ketë dhënë dorëheqje për shkak të kërcënimeve për punën e tij. Drejtuesit e organeve të rendit kanë bërë me dije se nuk kanë informacione nëse Blakaj ka dhënë dorëheqje për shkak të kërcënimeve, megjithatë ata kanë kërkuar hetim të plotë të këtij rasti



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 15 GUSHT - Elez Blakaj që nga e hëna ka dhënë dorëheqje nga pozita e prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK). Blakaj, që ishte duke i hetuar dyshimet për keqpërdorime në listat e veteranëve të UÇK-së, më nuk do të jetë pjesë e sistemit prokurorial të Kosovës. Ndonëse nuk është konfirmuar zyrtarisht, Blakaj thuhet të ketë dhënë dorëheqje për shkak të kërcënimeve për punën e tij. Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka bërë me dije se asnjëherë nuk është informuar me shkrim nga prokurori Elez Blakaj se ka pasur ndonjë kërcënim në lidhje me punën e tij. "Zyrtarisht deri më sot ne kemi pranuar vetëm dorëheqjen e tij të cilën e ka drejtuar te kryeprokurori i PSRK-së, Reshat Millaku. Sidoqoftë, dëshirojmë ta informojmë opinionin se prokurori Blakaj, përderisa ishte duke hetuar rastin e njohur në opinion si 'Lista e veteranëve të UÇK-së', kishte marrë informacione se Komisioni i Mjekëve në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ishte duke u marrë me përcaktimin e statusit të invalidëve të luftës dhe se gjatë punës së këtij komisioni ka pasur kanosje, për të cilën edhe është hapur rasti në Policinë e Kosovës. Kërkesa e prokurorit Blakaj është shqyrtuar dhe Policia e Kosovës ka vendosur

sur t'i shtojë patrullimet në vendin ku komisioni po punonte si dhe në vendosjen e kontakteve të kohëpaskohshme në mënyrë që procesi të vazhdojë sipas planifikimit. Megjithatë, prokurori Blakaj nuk ka raportuar për këtë rast se ka ndonjë kërcënim ndaj tij", është thënë në deklaratën për medie të Kryeprokurorit të Shtetit Aleksandër Lumezi. Por, është theksuar se kryeprokurori i Shtetit ka pasur informacione se prokurori Blakaj ka marrë një mesazh kërcënues në rrjetin social "Facebook", megjithatë, pas raportimit të këtij rasti në polici, ai ishte deklaruar se nuk ndihet i kërcënuar. "Po ashtu, kryeprokurori i Shtetit ka informacione se prokurori Blakaj në llogarinë e vet në rrjetin social 'Facebook' ka pranuar një mesazh kërcënues me fjalët: 'Dënoi kriminelët, e jo hoxhallarët', kurse më pas prokurori Blakaj e ka raportuar në polici, ku ka deklaruar se veten nuk e ndien të kërcënuar, por është i brengosur për familjen e vet, sidomos për fëmijët dhe ka kërkuar përcjelljen nga njësitet policore të fëmijëve të tij gjatë vajtje-ardhjes në shtëpi - shkollë. Policia e Kosovës ka shqyrtuar kërkesën e prokurorit Blakaj dhe të nesërmen ka filluar ofrimin e përcjelljes së fëmijëve të prokurorit Blakaj", është thënë më tutje në deklaratën për medie të kryeprokurorit të Shtetit. Ndërkohë ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka kërkuar hetim

të plotë lidhur me dorëheqjen e prokurorit Elez Blakaj. "Pa dashur të aludoj në rrethanat e ngjarjes, në rast se zyrtarisht konstatohet se arsyet e dorëheqjes së prokurorit janë të natyrës personale, konsideroj se një hetim i plotë rreth këtij rasti duhet të zë vend, për të parë se kush ka kërcënuar prokurorin dhe në rast se organet e pavarura të zbatimit të ligjit kanë ndërmarrë masat e nevojshme për të adresuar dhe rrënuar deri në fund çdo kërcënim të mundshëm ndaj tij, kurdo qoftë dhe nga kushdo qoftë. Në kohën kur të gjitha përpjekjet tona si institucione janë duke u orientuar në fuqizimin e sundimit të rendit dhe ligjit, një mesazh i tillë është tërësisht i papranueshëm dhe meriton trajtim emergjent deri në fund", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook". Ai e ka quajtur të papranueshme që një prokuror i shtetit për punën që bën të bie nën presionin e kërcënimeve dhe ta zgjedhë dorëheqjen si alternativë. "Republika jonë është e ndërtuar mbi parime, ku sundimi i ligjit është mbi të gjithë, i barabartë për të gjithë dhe se askush nuk mund të ngrihet mbi të e aq më pak ta cenojë funksionimin e organeve të rendit për shkak të detyrës zyrtare në vendosjen e drejtësisë. Është e

papranueshme që një prokuror i shtetit për punën që bën të bie nën presionin e kërcënimeve dhe ta zgjedhë dorëheqjen si alternativë. Krimi, korrupsioni, shmangia nga përgjegjësia dhe abuzimi në këtë vend duhet të marrin fund njëherë e përgjithmonë. Republika e Kosovës ka nevojë për prokurorë të zotë që për punën e tyre i japin llogari vetëm ligjit dhe askujt tjetër dhe të gjitha organet e tjera kanë për obligim të sigurojnë

pacenueshmërinë e punës së tyre nga kushdo. Nuk do të lejojmë për asnjë çast që shteti ynë të duket i brishtë dhe nuk do të tolerojmë askënd dhe asgjë që të jetë mbi ligjin", ka deklaruar Tahiri. Sipas tij, ky rast është një ftesë për krerët e institucioneve të sistemit të drejtësisë për të pasur një koordinim më të ngushtë që adreson çdo defekt të sistemit në mënyrë të përgjegjshme, të pakompromis dhe të paalternativë.

Delawie: Dorëheqja e prokurorit Blakaj, ditë e pikëlluar për drejtësinë

Ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, ka reaguar lidhur me dorëheqjen e prokurorit Elez Blakaj. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", Delawie ka thënë se kjo është një ditë e pikëlluar për sundimin e ligjit në Kosovë. "Një ditë e pikëlluar për drejtësinë në Kosovë, ku prokurori jep dorëheqje për shkak të kërcënimeve dhe mungesës së përkrahjes. Është shqetësuese në veçanti kur ai ishte duke punuar në rastin e mashtrimit masiv të pensioneve", ka shkruar Delawie. Ambasadori amerikan ka thënë se Kosova duhet ta dëshmojë

angazhimin për sundimin e ligjit jo vetëm duke mbështetur prokurorët, por edhe duke siguruar që të gjithë ata që janë të dënuar ta kryejnë dënimin. "Është dekurajuese ta dëgjosh lajmin për dorëheqjen e prokurorit special Elez Blakaj, posaçërisht pasi ai po punonte në çështje të rëndësishme siç janë mashtrimet e mëdha në listat e veteranëve. Ai kishte pasur mbështetjen e Qeverisë amerikane për të studiuar në Wake Forest, ku mori diplomën në LLM dhe hetoi raste të rëndësishme në Kosovë", ka theksuar Delawie.

Ambasadori Delawie kërkon të vazhdohet reforma në arsim



PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, të mërkurën ka pritur në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Greg Delawie, me të cilin ka biseduar për sistemin arsimor në Kosovë. Ministri Bytyqi fillimisht ka falënderuar ambasadorin amerikan në Kosovë, Greg Delawie, për takimin e sotëm dhe e ka njoftuar për gjendjen e përgjithshme në sistemin arsi-

mor dhe në MASHT. Gjithashtu, ministri Bytyqi gjatë këtij takimi ka diskutuar për hapat e ndërmarrë deri më tani në funksion të përmirësimit të sistemit arsimor, të gjendjes në ministri, si dhe për vështirësitë nëpër të cilat po kalojmë, por edhe për vendosmërinë për t'i lëvizur gjërat përpara. Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, ka thënë se është i inkurajuar që MASHT-i ka identifikuar reformat që

duhet të bëhen për ta përmirësuar sektorin arsimor të Kosovës, përfshirë edhe brenda ministrisë. "Qeveria/Ambasada e ShBA-së dëshiron të shohë që MASHT-i dhe Qeveria e Kosovës kanë zbatuar reforma të qëndrueshme sepse rinia e Kosovës meriton më mirë", ka thënë Delawie. Në fund të takimit palët janë pajtuar për rëndësinë e reformave si dhe për nevojën e depolitizimit të sistemit arsimor në vend.

Flet për "Epokën e re" presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

Korrigjimi i kufirit shuan ëndrrën

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se korrigjimi i kufirit me Serbinë fundos ëndrrën serbe për ndarje apo bosnjëzim të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se ata që e kundërshtojnë këtë ide janë kamikazë të fuqishëm politikë. Shefi i shtetit është zotuar se për këtë çështje dhe për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë do ta thonë fjalën qytetarët e Kosovës nëpërmjet referendumit. Presidenti Thaçi ka theksuar se nuk do të lejojë askënd ta bllokojë arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, e cila, sipas tij, siguron të ardhme evropiane për shtetin e Kosovës. Ai e ka ftuar opozitën të bëhet pjesë e dialogut pasi, sipas tij, ballafaqimi i argumenteve duhet të ndodhë në tavolinë. Presidenti ka thënë se nuk do të lejojë që Asociacioni i Komunave Serbe të ketë kompetenca ekzekutive. Thaçi ka shprehur optimizëm se një bazë e mirë e marrëveshjes me Serbinë do të arrihet në pranverë të vitit të ardhshëm

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 GUSHT - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka shprehur bindjen se korrigjimi i kufirit me Serbinë shmang njëherë e përgjithmonë planin serb për ndarjen apo bosnjëzimin e Kosovës. Ai ka kërkuar mbështetjen e partive politike që nëpërmjet korrigjimit të kufirit të ndodhë bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëse Kosova dhe Serbia pajtohen për këtë çështje, ato do të përkrahen edhe nga ShBA-ja dhe BE-ja. "Ideja për korrigjimin e kufirit përfundimisht shuan ëndrrën serbe për ndarje apo bosnjëzim të Kosovës. Prandaj është në interesin tonë që sa më herët kjo të ndodhë. Marrëveshja e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë nëpërmjet një procesi të dialogut dhe rrugës paqësore do të jetë e mirëpritur dhe e mbështetur fuqishëm dhe në mënyrë unike edhe nga ShBA-ja dhe BE-ja", ka thënë Thaçi. Ai ka bërë me dije se do ta vazhdojë fazën finale të dialogut edhe nëse opozita nuk bëhet pjesë e këtij procesi. Sipas presidentit Thaçi, nëse has në kundërshtim të subjekteve politike për këtë proces, marrëveshjen përfundimtare me Serbinë dhe çështjen e bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën do ta hedhë në referendum.

I pari i vendit ka qartësuar se askush nuk do të mund ta bllokojë këtë proces, i cili, sipas tij, garanton të ardhmen euroatlantike të shtetit të Kosovës. "Në fund të procesit vetë populli i Kosovës do të deklarojë nëse është për marrëveshje përfundimtare me Serbinë dhe nëse Lugina e Preshevës do t'i bashkëngjitet Kosovës, me një përgjigje shumë të thjeshtë, po ose jo. Deri më tani, prej të dhënave që kemi ne, mbi 90 për qind e qytetarëve të Kosovës e mbështesin bashkëngjitjen e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën, kurse rreth 99 për qind e shqiptarëve që jetojnë në Luginë të Preshevës e mbështesin këtë ide", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se ata që e kundërshtojnë këtë ide

janë kamikazë të fuqishëm politikë.

Thaçi ka shprehur bindjen se do ta marrë përkrahjen e nevojshme të qytetarëve në referendum për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. "Çdo marrëveshje që nënkupton njohje reciproke, anëtarësim të Kosovës në OKB dhe në organizata të tjera ndërkombëtare, do ta marrë bekimin e qytetarëve të Kosovës. Jam i bindur në këtë. Nuk do të lejoj asnjë individ që me mandatin e fituar si deputet të pretendojë ta pengojë implementimin e të ardhmes euroatlantike", është shprehur Thaçi.

"Epoka e re": Z. president, kancelarja gjermane Angela Merkel ka mohuar çdo mundësi të ndryshimit të kufijve në Ballkanin Perëndimor. Cili është qëndrimi juaj ndaj kësaj deklaratë?

Thaçi: Deklarata e kancelares Merkel është një qëndrim i munguar për kohë të gjatë për Ballkanin Perëndimor. Të gjithë jemi kundër ndarjes dhe shkëmbimit të territoreve. Gjithashtu, duhet të punojmë fuqishëm që në asnjë rrethanë të mos krijohet ndonjë situatë e krijimit të ndonjë autonomie serbe apo të ndonjë modeli të Srpska Republikës. Ideja ime për korrigjimin e kufirit është ide për demarkimin e rreth 400 kilometrave kufij në mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Kjo gjë do të ndodhë herët apo vonë. Derisa nuk ndodh demarkimi i kufirit Kosovë - Serbi, as Kosova nuk do të mund të lëvizë drejt NATO-s dhe BE-së, por as Serbia nuk do të mund të lëvizë drejt perspektivës evropiane. Tani kur BE-ja po modernizohet dhe reformohet, është kërkesë e qartë e lidershit evropian se asnjë vend i Ballkanit Perëndimor me probleme të së kaluarës nuk do të mund të jetë pjesë e familjes evropiane pa i tejkaluar ato probleme. Mundësia e arritjes së marrëveshjes Kosovë - Serbi, që nënkupton edhe përfshirjen e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën, është minimale, por tani është kërkesë e institucionalizuar nga liderët e Luginës së Preshevës të cilën do ta prezantoj në tryezë në Bruksel. E di që do të jetë një reagim jo i lehtë nga ana e autoriteteve të Serbisë,

mirëpo këtë e ndiej si obligim moral, historik, kombëtar, politik dhe shtetëror. Çdo marrëveshje mes palëve, që nënkupton njohjen reciproke mes Kosovës dhe Serbisë dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, bota do ta përkrahë.

"Epoka e re": Nga shumëkush kjo deklaratë e Merkelit është interpretuar si kundërpërgjigje ndaj jush, që po e proklamoni idenë e korrigjimit të kufirit me Serbinë?

Thaçi: Korrigjimi dhe demarkimi i kufirit është diçka tjetër. Ideja për korrigjimin e kufirit përfundimisht shuan ëndrrën serbe për ndarje apo bosnjëzim të Kosovës. Prandaj është në interesin tonë që sa më herët kjo të ndodhë. Marrëveshja e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë nëpërmjet procesit të dialogut dhe rrugës paqësore do të jetë e mirëpritur dhe e mbështetur fuqishëm edhe nga ShBA-ja dhe BE-ja.

"Epoka e re": Domethënë, edhe pas deklaratës së Merkelit, ju nuk tërhiqeni nga ideja për korrigjimin e kufirit me Serbinë, nëpërmjet së cilës do të ndodhte bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën?

Thaçi: Unë pajtohem qind për qind me kancelaren Merkel. Ajo e ka thënë gjënë e duhur në kohën e duhur. E theksova më herët se kjo është diçka që i ka munguar diplomacisë ndërkombëtare kohët e fundit. Edhe në takimin që kam zhvilluar me kancelaren Merkel, ajo ka bërë me dije se është në favor të dialogut dhe arritjes së marrëveshjes paqësore Kosovë - Serbi, që nënkupton edhe demarkimin e kufirit në mes të dy vendeve, rreth 400 kilometra.

"Epoka e re": Z. president, pse dhatë këtë ide në këtë kohë?

Thaçi: Sepse tani është institucionalizuar kërkesa e liderëve politikë të shqiptarëve të Luginës së Preshevës drejtuar institucioneve të Republikës së Kosovës. Një deklaram ky i shprehur edhe në vitin 1992 përmes referendumit të qytetarëve atje.

"Epoka e re": Meqenëse edhe vetë



po e pranoni se ka pak gjasa që Serbia ta pranojë kërkesën tuaj, pse po e proklamoni kaq shumë këtë ide?

Thaçi: Mendoj se kjo është një e drejtë historike dhe legjitime e cila duhet të promovohet. Do të jetë e vështirë të shtyhet përpara, por ia vlen të përpiqemi.

"Epoka e re": Opozita, edhe individë të tjerë, po ju kritikojnë se me këtë ide po krijoni jostabilitet në raportet e Kosovës me bashkësinë ndërkombëtare?

Thaçi: Bashkësia ndërkombëtare do ta përkrahë marrëveshjen e arritur Kosovë - Serbi, në një proces të dialogut të mirëfilltë, të hapur, llogaridhënës, transparent dhe paqësor. Marrëveshja paqësore Kosovë - Serbi nuk do të mund dhe nuk do të jetë e refuzuar nga askush.

"Epoka e re": Nuk është hera e parë që opozita ju akuzon për tentim të prishjes së raporteve të Kosovës me partnerët ndërkombëtarë. Fillimisht këto kritika ishin drejtuar kur tentuat ta bëni transformimin e FSK-së në ushtri nëpërmjet ligjit, pastaj këto kritika erdhën edhe në shprehje edhe kur u aktualizua iniciativa për bllokimin e Gjykatës Speciale?

Thaçi: Sa i përket themelimit të Forcave të Armatosura, e gjithë

bota na ka përkrahur në angazhimin tonë në vitin 2014 për ta themeluar ushtrinë. Mirëpo kanë qenë 4-5 deputetë që e kanë penguar këtë proces për shkak të ambicieve të tyre politike, egrove personale dhe politikave elektorale populiste. Për shkak të këtyre ambicieve sot Kosova po e paguan çmimin që nuk e ka mundësinë për ta formuar ushtrinë e Kosovës. Pa ushtri nuk do të mund të jemi as në partneritet të paqes dhe as në NATO. Pra, për shkak të naivitetit dhe injorancës të disa individëve, Kosova po e paguan këtë çmim sot. Sa i përket proceseve të tjera, mendoj se ka keqkuptime, keqinterpretime dhe ka frustrime të ndryshme prej individëve të ndryshëm. Kjo është jeta politike dhe plurale. Ne jetojmë në demokraci, ku secili mund të shprehet lirshëm. Për mua të gjithë janë të respektuar, por Kosova nuk mund të humbë kohë me politika inatçore apo me politika të interesit ditor. Dialogu Kosovë - Serbi, nëse prodhon ndonjë bazë për marrëveshje apo ndonjë marrëveshje definitive, ne do të punojmë që të kemi një përfshirje sa më të gjerë politike, sepse të gjithë kanë përgjegjësi në këtë proces. Beteja me Serbinë zhvillohet në tavolinat e bisedimeve përballë Serbisë, e jo duke u ankuar se nëse

Thaçi: Një bazë serbe për ndarje të Kosovës



zgjidhet problemi i Kosovës, çfarë do t'i ndodhë Ukrainës apo çfarë do të ndodhë me problemet e tjera globale. Ne jemi shumë të vegjël që të merremi me probleme globale siç pretendojnë disa individë që nuk kanë fituar legjitimitet as në fshatin e vet e lëre më të merren me Krime apo Abkhazi. Rithekoj se korrigjimi i kufijve dhe përfshirja e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën, përfundimisht e shuan ëndrrën e kamotshme të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë për ndarjen e Kosovës apo krijimin e Republika Srpskas në Kosovë. Është me interes të rithekoj se i gjithë procesi duhet të përcillet me transparencë të plotë dhe llogaridhënie dhe në fund të fundit qytetarët përmes referendumit do ta thonë fjalën e vet dhe vullnetin e tyre.

"Epoka e re": Kur do të ndodhë takimi i ardhshëm me presidentin serb Vuçiq?

Thaçi: Shpresoj në pjesën e parë të shtatorit.

"Epoka e re": Dhe çfarë pritet të diskutoni në këtë takim?

Thaçi: Ende nuk është specifikuar se çka. Dy takimet e para më tepër kanë qenë procedurale dhe teknike. Besoj se takimi i radhës do të jetë i menduar për të filluar me

një bazë të diskutimit për të ardhmen.

"Epoka e re": Kosova po hyn në këtë fazë të ndjeshme të këtij procesi dhe ende nuk është arritur konsensusi i kërkuar politik dhe nuk është hartuar ndonjë platformë për fazën finale të dialogut me Serbinë.

Thaçi: Platformë për ne është e drejta jonë historike dhe prioritetet që i kemi para nesh. Më vjen keq që disa që shprehin kritika për këtë proces nuk kanë ide se çka duhet bërë për të ardhmen, por vetëm janë pozicionuar në istikamet refuzuese pa prezantuar ndonjë ide konkrete se si të lëvizet drejt një të ardhme euroatlantike të Kosovës. Me rëndësi është që të gjithë bartësit e institucioneve të Kosovës kanë qenë të pranishëm në takimin e fundit në Bruksel. Shpresoj se edhe në takimin e radhës do të jenë. Ne do të punojmë të kemi një përfshirje sa më të gjerë të mundshme, mirëpo askujt nuk do t'ia imponojmë participimin në këtë proces. Pasi që procesi do të kalojë nëpërmjet referendumit, mendoj se secili ka mundësi ta thotë fjalën e vet dhe nuk do të mund ta pengojë askush i vetëm këtë proces, kushdo që të jetë ai. Në fund të procesit, vetë populli i Kosovës do të deklarohet nëse është për marrëveshje

përfundimtare me Serbinë dhe nëse është që Lugina e Preshevës t'i bashkëngjitet Kosovës me një përgjigje shumë të thjeshtë, po ose jo. Deri më tani, prej të dhënave që kemi ne, mbi 90 për qind e qytetarëve të Kosovës e mbështesin bashkëngjitjen e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën, kurse rreth 99 për qind e shqiptarëve që jetojnë në Luginë të Preshevës e mbështesin këtë ide. Prandaj ata që kanë guxim të dalin kundër një propozimi të tillë mendoj se janë kamikazë të fuqishëm politikë.

"Epoka e re": Vazhdimisht po e përmendni mundësinë e organizimit të referendumit për këtë çështje, por Kosova ende nuk ka ligj për referendum. Madje, sipas disa interpretimeve, Kushtetuta jonë e ndalon organizimin e referendumeve për disa çështje. Si do t'ia bëni?

Thaçi: Duhet të punojmë në aspektin procedural dhe ligjor. Duhet të punojmë edhe me Gjykatën Kushtetuese që ta marrim opinionin e saj dhe t'i fillojmë procedurat në mënyrë që bashkërisht të gjithë të ecim në këtë drejtim. Nuk mendoj se dikush do të dalë kundër kësaj ideje për referendum. Mendoj se për çështjet me rëndësi jetike, qytetarët e Kosovës duhet të

vendosim vetë. Referendumi është mekanizmi më i lartë i demokracisë dhe qytetarët e vendit duhet mendojnë se duhet t'u jepet mundësia ta shprehin vullnetin e tyre për të ardhmen.

"Epoka e re": Sa herë është përmendur mundësia e organizimit të referendumit, çdoherë është tërhequr edhe vërejtja se kjo e drejtë mund të keqpërdoret nga ndonjë komunitet. I frikësoheni kësaj?

Thaçi: Nuk punoj me paragjykime. Unë punoj mbi bazën e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe standardeve demokratike evropiane dhe botërore. Në këtë mënyrë referendumi është një mekanizëm që duhet të garantohet edhe në Kosovë.

"Epoka e re": Si president i vendit do t'i ftoni në mënyrë zyrtare subjektet politike për të diskutuar rreth platformës për bisedime me Serbinë?

Thaçi: Ftesa gjithmonë është e hapur. Bashkëngjitja e opozitës në këtë proces është e mirëseardhur. Me rëndësi është të vazhdojë dialogu, të gjendet zgjidhja, të arrihet marrëveshja dhe Kosova të lëvizë drejt NATO-s dhe BE-së. Nuk do të humb kohë në asnjë rrethanë dhe për asnjë ditë për idetë lokale, projektet lokale apo hartat lokale. Ne duhet të shikojmë në hartën e madhe evropiane për arritjen e standardeve evropiane për Kosovën dhe Ballkanin. Pra, për një rajon pa kufi, i cili do të jetë i integruar në BE.

"Epoka e re": Çfarë nëse nuk do ta keni mbështetjen e opozitës në këtë proces?

Thaçi: Opozita dhe të gjitha partitë politike janë në favor të dialogut, janë për negociatën, ndërsa ballafaqimi i argumenteve duhet të ndodhë në tavolinë. Shumë lehtë është të jemi kritikë dhe shumë vështirë është të ballafaqohesh me kundërshtarët e Kosovës. Nuk është e lehtë as për mua të ballafaqohem me Vuçiqin. Lehtë është të qëndrosh si spektator, por vështirë është të luash. Kështu që edhe subjektet politike duhet të futen në lojë dhe t'i marrin përgjegjësit gjatë betejës. Nëse nuk duan, në fund të këtij procesi, nëse arrijmë ndonjë marrëveshje, atëherë duhet që qytetarët nëpërmjet referendumit të deklarohen për ose kundër kësaj marrëveshje.

"Epoka e re": Keni paralajmëruar se ky proces mund të përfundojë në qershor të vitit të ardhshëm.

Thaçi: Nuk shpresoj se do të arrihet shpejt, por mendoj se një bazë e mirë për një marrëveshje mund të krijohet në pranverë të vitit të ardhshëm.

"Epoka e re": Meqenëse vetë e keni pranuar se ky do të jetë një proces shumë i vështirë dhe me të

panjohura, si do t'i hyni këtij procesi pa mbështetjen e opozitës?

Thaçi: Presidenti ka mandatin e vet kushtetues dhe ligjor. Kuvendi askund në botë nuk udhëheq dialog apo negociatën me një vend. Kuvendi ratifikon ose jo një marrëveshje ndërkombëtare. Nëse duan, marrëveshjen e mundshme do ta kalojnë nëpërmjet Kuvendit, por nëse ka veprime kryeneçe atëherë ne përfundimisht duhet të vëmë në funksion mekanizmin e referendumit, gjë që do ta bëjmë. Por, nuk do të lejoj që të vë veto askush mbi këtë proces.

"Epoka e re": Por përsëri ajo marrëveshje duhet të silltet në Kuvend për ratifikim?

Thaçi: Le ta bekojë populli atë marrëveshje, pastaj gjërat e tjera vijnë në vendin e vet. Qytetarët duhet të deklarohen për këtë çështje. Nëse e pranon populli, në rregull; nëse nuk e pranon, në këtu jemi.

"Epoka e re": Idenë e referendumit nuk e keni përmendur më herët. Do të thotë kjo se jeni i ndikuar nga rasti i marrëveshjes historike në mes të Greqisë dhe Maqedonisë për emrin e kësaj të fundit, e cila në shtator do të hedhet në referendum?

Thaçi: Marrëveshja në mes të Greqisë dhe Maqedonisë mendoj se është marrëveshje shumë e mirë. Kjo marrëveshje duhet të shërbejë për të na i hapur sytë edhe neve që të lëvizim sa më shpejt për ta përmbyllur këtë proces, në mënyrë që të na hapet rruga për integrim në NATO dhe BE. E rithekoj edhe një herë se nuk ka ecje përpara as për Kosovën e as për Serbinë pa marrëveshje reciproke. Çdo marrëveshje që nënkupton njohje reciproke, anëtarësim të Kosovës në OKB dhe në organizatën tjetra ndërkombëtare, do ta marrë bekimin e qytetarëve të Kosovës. Jam i bindur në këtë. Nuk do të lejoj asnjë individ që me mandatin e fituar si deputet të pretendojë ta pengojë implementimin e të ardhmes euroatlantike.

"Epoka e re": Njohës të ndryshëm të rrethanave politike pretendojnë se mbrapa idesë suaj për korrigjim të kufirit fshihen kompetencat ekzekutive të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe?

Thaçi: Pikërisht korrigjimi i kufirit Kosovë - Serbi dhe integrimi i Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën eliminon përfundimisht pretendimet e tilla për pushtet ekzekutiv në Kosovë, duke nënkuptuar këtu edhe marrëveshjen e ish-kryeministrit Isa Mustafa me Vuçiqin për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, me pretendimin për pushtet të tretë ekzekutiv apo ndonjë pretendim për Republika Srpska në Kosovë. Diçka e tillë nuk do të lejoj të ndodhë.

Një ftesë për partitë politike për t'i rikthyer vlerat kombëtare



Jakup KRASNIQI

Nuk do të zgjatëm shumë. Po hyj drejt e në temë. Nga viti 2000 e këtej janë kryer disa palë zgjedhje për dy nivelet e pushtetit në Kosovë. Qëllim i vetëm nga atëherë e deri me sot ka qenë pushteti. Pushteti jo për t'i qeverisur pasuritë e vendit e të kombit, por për të sunduar duke plaçkëtur pasurinë publike për vete, për familjen dhe jo pak edhe për ndonjë servil pranë vetes. Për të qëndruar në pushtet, partitë që ishin në pushtet (në të dy nivelet), luftën me të gjitha mjetet e bënin për të grumbulluar sa më shumë vota. Deri te vota vinin në çdo mënyrë, vetëm jo në mënyrë të ndershme. Rruga e ndjekur deri tani

nga partitë e "vjetra" politike na ka sjellë këtu ku jemi. Ecja në këtë rrugë nuk ka destinacion tjetër veç këtij që e jetuam dhe këtë fat nuk ia kisha dëshiruar asnjë lloji njerëzor. Prandaj, si domosdoshmëri imediate na imponohet të kërkojmë rrugë tjetër, një rrugë njerëzore, rrugë që na jep më shumë shpresë e besim për ndryshim. Nuk ka dyshim, çlirimi i Kosovës dhe pavarësia kanë krijuar mundësi të shumta të cilat mundësi nuk i shfrytëzuan si e sa duhet.

Për të ecur tashmë një rrugë tjetër, për ta kthyer shpresën dhe besimin, na duhet një marrëveshje besa-besë (një besëlidhje!) në mes të njerëzve të politikës, besë skënderbegiane, besë për të mos mashtruar, por edhe besë për të ndryshuar për të mirën e kombit e të shtetit. Besën për t'u liru nga lakmia për të rrëmbyer për vete atë që është e kombit dhe që i përket vetë atij, e që është pronari legjitim i pasurisë e quajtur jorastësisht pasuri kombëtare! Besën për ta kërkuar votën

qytetare për të qeverisur mirë, e jo si deri më sot për të grabitur atë që nuk të takon, atë që është e huaja! Por, i gjithë problemi është a thua na ka mbetur ndonjë fije bese e njerëzve të motit, që kishin besë e trimëri njerëzish fisnikë? Nuk dyshoj, kishim njerëz fisnik e të besës, por sot ku u tretën ata, ç'u bë me ta, ku u tretën ato ideale e tradita të njerëzve të fisëm? Që e dhanë gjithçka kishin për Lirinë! Diku e diçka është gabuar shumë gjatë këtij rrugëtimi kombëtar thuaja tridhjetëvjeçar e po të kemi parasysh vitet pas '99-s, njëzetvjeçar me një ngarendje mbase edhe absurde. Kjo rrugë gjithsesi duhet ndryshuar, por a kemi vullnet politik, intelektual e kombëtar për atë ndryshim, ndryshim që na kthen vlerat tradicionale shqiptare, vlera që i nëpërkëmbëm gjatë këtyre njëzet-tridhjetë vjetëve të fundit. Sot e gjithë ditën na duhet një Besë për t'ia ndërprerë rrugën e krizës morale që na ka qitur jashtë binarëve të vlerave kombëtare dhe nuk jemi duke e ditur

se cilat vlera duhet t'i përqafojmë e cilat t'i shqelmojmë! Tonat apo ato që na lidhin me shekujt e robërisë e skllavërisë e që na janë ngjitur si ferrë murrizi në shumë pore të jetës? Të atyre ferrave që Migjeni i quante simbole të mjerimit e të errësirës. Shkurt, gjatë këtyre tri dekadave kemi një shkëputje të madhe nga vlerat tona kombëtare shqiptare dhe sorollatemi shumë pas vlerave të huaja, që jo pak herë na i kanë imponuar armiqtë e kombit ndër shekuj. Kthimi në origjinë na është bërë domosdoshmëri. Vlerat tona kombëtare të kultivuara nga fryma luftarake skënderbegiane nuk mund të ruhen e më pak të avancohen nga mashtrues, servilë, injorantë, frikacakë e sehixhinj të çdo ngjyre.

Mjaft e sunduan të huajt popullin e kombin tonë! Vendi dhe kombi duhet të qeverisen nga njerëzit që duan dhe dinë ta orientojnë atë në rrethanat e reja të krijuara pas shekujsh robërie. Adem Demaçi dhe Adem Legjendari na kanë mundësuar

shumë që ta korrim fitoren e madhe të qershorit 1999 dhe të 17 shkurtit 2008!

Shkëputja nga mashtruesit e viteve të pas '99-s, të luftës a të pritjes, çfarëdo qofshin, duhet të na ndajë me të gjitha rrugët e mjetet! Popullit tonë nuk i mungojnë njerëzit që dinë e duan të qeverisin mirë me vendin e shqipeve. Mashtruesit, me gjithë makineritë e vëna në shërbim të mashtrimit për sundim (përfshirë edhe mediet lehtësisht të shitura), duhet t'i dërgojmë në muzeun e vjetërsirave dhe kjo nuk arrihet dot pa vullnetin e shumicës qytetare! Aty ku duhet t'i dërgojmë çdo formë joshje financiare, mashtrimi apo kërcënimi që i zgjatë jetën gjendjes ekzistuese.

Është kohë zgjimi për sistemin e vlerave fisnike të kombit! Kështu siç jemi katan-disur, jemi larg, shumë larg vlerave të konsoliduara të kombit shqiptar! Le të nis ndryshimi, nëse jo nga politika, le ta fillojnë qytetarët, sovranit i ndryshimeve të deritashme!

Murati: Kosovës po i përgatitet skenari më i keq i mundshëm



Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 15 GUSHT - Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën ka thënë se zhurmat e fundit për korrigjim kufijsh na bëjnë të frikësohemi se Kosovës po i përgatitet skenari më i keq i mundshëm, ai i instalimit të Asociacionit të Komunave Serbe, i cili në rrethanat e një dialogu ku po flitet për mar-

rëveshje përfundimtare, mund të përfundojë me kompetenca ekzekutive dhe me autonomi politiko-territoriale.

Duke rikujtuar se bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë pritet të futen në një fazë kritike nga muaji shtator i këtij viti, ai ka thënë se, fatkeqësisht, opinioni publik dhe partitë politike janë më të përçara se kurdoherë rreth kësaj teme dhe se Kosovës i mungon platforma politike për këto bisedime e, rrjedhimisht, edhe konsensusi poli-

tik për to. Sa i përket qëndrimit të Lëvizjes për Bashkim rreth çështjes shqiptaro-serbe, Murati ka pohuar se kjo parti që prej vitit 2008 ngulmon se boshiti rreth të cilit duhet të ndërtohet platforma për bisedime me Serbinë është parimi i reciprocitetit. "Kjo nënkupton reciprocitet në të drejta në mes të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, me ato të serbëve në Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok. Zbatimi me konsekuencë i

parimit të reciprocitetit, nëse rrethanat ndërkombëtare e lejojnë, mund të shkojë edhe deri në ridefinim (ripërcaktim) të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë, gjithnjë duke u bazuar në vullnetin e popujve: aty ku shqiptarët në tri komunat e Kosovës Lindore janë shumicë dhe kanë vazhdimësi territoriale me Kosovën të kenë të drejtën të bashkohen me Kosovën dhe aty ku serbët në tri komunat veriore janë shumicë dhe kanë vazhdimësi territori-

ale me Serbinë të kenë të drejtën të bashkohen me Serbinë", ka thënë ai.

Ndërsa sipas platformës së LB-së, as në konceptin e reciprocitetit e as të ridefinimit (ripërcaktimit) të kufijve nuk duhet të përfshihet pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës. "Në këtë pjesë 12 000 shqiptarë janë dëbuar me dhunë në vitin 2000 dhe institucionet tona duhet të punojnë që ata të kthehen atje", ka thënë Valon Murati, kryetar i LB-së.

Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka pritur në takim edhe kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka

Ka vullnet politik për përfaqësimin e diasporës në Kuvendin e Kosovës

Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, dhe kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, kanë biseduar të mërkurën për procesin e zgjedhjeve, votimin e pjesëtarëve të diasporës, por edhe për përfaqësimin e bashkatdhetarëve në Kuvendin e Kosovës. Në takim u potencua se ka vullnet politik nga subjektet politike për përfaqësimin e diasporës në Kuvendin e Kosovës



"Epoka e re", ministri Dardan Gashi kishte thënë se ka pasur diskutime për ta filluar reformimin e listës zgjedhore. Ai ka thënë se në këtë proces Ministria e Diasporës do të jetë pjesë e çdo diskutimi me idenë që t'i përfaqësojë interesat e diasporës, në këtë rast interesat dhe kërkesat politike. "Diaspora gjithqysh duhet të jetë pjesë e sistemit politik të Kosovës, duke pasur parasysh se ne kemi mbi 700 mijë banorë vetëm në Evropë që janë me orgjinë nga

Kosova dhe që kanë të drejtën e votës. Mirëpo, procesi, si i tillë, nuk ua mundëson që në mënyrë adekuate të jenë të përfaqësuara në sistem. Ju e dini se prej 700 mijë personave kanë marrë pjesë vetëm 10 mijë prej tyre në zgjedhjet e kaluara. Kjo ka qenë pjesëmarrja më e lartë deri më tani, por që është larg prej nevojave që ka diaspora dhe të drejtën që ata e kanë për të qenë të përfaqësuar", është shprehur ai. Ministri Gashi ka thënë se par-

titë politike kanë mendime të ndryshme për përfaqësimin politik të diasporës në institucionet e Kosovës. "Një prej këtyre mendimeve është që diaspora t'i ketë në Kuvendin e Kosovës 5 deri në 6 vende të rezervuara. Ky nuk është problem, sepse ne mund t'ua rezervojmë edhe vendet diasporës, mirëpo problemi është se nuk funksionon sistemi zgjedhor për diasporën. Deri tash KQZ-ja ka dështuar të organizojë zgjedhje për diasporën", ka thënë Gashi.

EPOKA
ERE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 15 GUSHT - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka pritur të mërkurën në takim kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka. Në këtë takim është biseduar për procesin e zgjedhjeve, votimin e pjesëtarëve të diasporës, por edhe për përfaqësimin e bashkatdhetarëve në Kuvendin e Kosovës. Zëvendëskryeministri Gashi dhe kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, u pajtuan që diaspora duhet të informohet më shumë për votimin përmes uebfaqeve të institucioneve, përmes tryezave që planifikohen të mbahen me përfaqësuesit e

diasporës, edhe përmes shoqatave, asociacioneve e organizimeve të ndryshme, të cilat mund të shërbejnë edhe si pika të grumbullimit të materialeve zgjedhore për votim jashtë Kosovës. Po ashtu në takim u potencua se për përfaqësimin e diasporës në Kuvendin e Kosovës ka vullnet politik nga subjektet politike të Kosovës dhe në një të ardhme të afërt do të organizohen takime, debate, tryeza dhe organizime të ndryshme për procesin e votimit të diasporës.

Gashi dhe Daka u pajtuan ta thellojnë bashkëpunimin, me qëllim që përfaqësuesve të diasporës t'ua bëjnë më të lehtë votimin dhe të shihet mundësia e përfaqësimit të tyre në Kuvendin e Kosovës. Më herët, në një intervistë për gazetën

Brenda 22 muajsh Kosova me Spital të Kirurgjisë Pediatrike

EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar të mërkurën lokacionin ku ka nisur ndërtimi i Spitalit Pediatrik dhe Kirurgjisë së Fëmijëve në kompleksin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Ai është shprehur i lumtur që u është dhënë fund zvarritjeve në realizimin e këtij projekti dhe se pas 22 muajsh shteti i Kosovës do të ketë një spital modern që do t'i integrojë të gjitha shërbimet shëndetësore për fëmijë brenda një institucioni. "Ky është një projekt, donacion i Emirateve të Bashkuara Arabe, gurthemeli i të cilit është vendosur disa vjet më herët, por që nuk ka mundur ta fillojë punën si është dashur. Ne i kemi shtuar përpjekjet tona që t'i kryejmë të gjitha procedurat. Kemi kontaktuar me donatorin kryesor dhe me konsorciumin e tyre që

kanë qenë mbikëqyrës gjermanë dhe kemi arritur ta zhbllokojmë procesin", ka thënë Ismaili. Ai ka shpjeguar se Spitali Pediatrik Kirurgjik do të jetë modern do të ketë pajisje moderne.

Sipas Ismailit, ky spital do të ketë 10 mijë metra katrorë hapësirë. "Projekti është i paraprirë të kryhet për 22 muaj. Objekti do të jetë me ura lidhëse me klinika, projekt i çmueshëm për fëmijët tanë, me kualitet të lartë si ndërtime dhe pajisje moderne", është shprehur ministri Ismaili.

Drejtori i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka thënë se nevoja për këtë spital ka qenë e madhe meqë shumë fëmijë kanë nevojë për trajtim. "Përfundimi i punimeve pas 22 muajve do të mundësojë kushte shumë të mira, duke llogaritur edhe infrastrukturën tjetër përcjellëse në të gjitha hapësirat e QKUK-së. Do të jetë kompletim i infrastrukturës dhe me pajisje



dhe fëmijët do të gjejnë trajtim më të lehtë", ka thënë ai. Në Spitalin Pediatrik dhe të Kirurgjisë së Fëmijëve do të ofrohen shërbimet pediatrike, shërbimet e kirurgjisë pedi-

atrike, hemato-onkologjia e fëmijëve, diagnostika, shërbimet emergjente si dhe shërbime të tjera. Spitalit Pediatrik Kirurgjik është projekt që do të kushtojë rreth 20 milionë euro,

donacion nga Emiratet e Bashkuara Arabe, i ndarë për Republikën e Kosovës më 2015, ndërsa simbolikisht gurthemeli i spitalit ishte vendosur në mars 2016.

Kriza e valutës në Turqi hëpërhë nuk ka efekt në Kosovë



PRISHTINË, 15 GUSHT - Zhvlerësimi i valutës kombëtare turke mund të ketë ndikim indirekt në ekonominë e Kosovës, konsiderojnë ekspertë për çështje ekonomike. Lira turke ka shënuar rënie rekorde prej 6.97 ndaj dollarit para dy ditësh, që nënkupton humbje të vlerës së kësaj valute në këtë vit për 46 për qind.

Turqia është një prej shteteve me praninë më të madhe të importit dhe investimeve direkte në Kosovë. Sipas ekspertëve, kriza në Turqi mund ta rrisë vlerën e importeve të produkteve, por që mund ta zvogëlojë vlerën e eksporteve. Ndërkaq, ndikimet tek investimet e huaja direkte të shtetit të Turqisë në Kosovë mund të vërehen në një periudhë më të gjatë, nëse kriza vazh-

don.

Lekë Musa, ish-kryeshef ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane në Prishtinë, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se efekte të pakta pozitive mund të ndihen tek ulja e çmimeve të produkteve të importuara nga Turqia në Kosovë, kurse tek investimet direkte kjo mund të vërehet më vonë. "Në periudhën afatshkurtër nuk pres që mund të ketë ndonjë ndikim. Mirëpo, nëse do të kishte një ndikim afatgjatë në ekonominë dhe pozitën e investitorëve turq, atëherë mund të ketë ndikim", është shprehur Musa.

Edhe Alban Hashani, drejtor ekzekutiv në Institutin "Riinvest", në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ka theksuar se importi i mallrave nga

Turqia mund të rritet për shkak të zhvlerësimit të monedhës turke krahasuar me valutën euro, por që eksporti mund të zvogëlohet. "Kosova importon mallra nga Turqia dhe këto mallra i bën më të lira për tregtarët e Kosovës. Ndikimi tjetër që mund të ndikojë në mënyrë indirekte është në qoftë se kriza e valutës në Turqi do të mund të zgjerohet edhe në eurozonë, që janë partnerë të rëndësishëm tregtarë të Kosovës dhe Turqisë, për shkak se një numër i madh i bankave evropiane i janë ekspozuar riskut valutator të Turqisë", ka thënë Hashani.

Vlerat e importit të mallrave turke në Kosovë vitin e kaluar kanë qenë rreth 300 milionë euro, duke e radhitur në vendin e tretë, pas Serbisë dhe

Gjermanisë, përderisa eksporti i produkteve të Kosovës në Turqi ka qenë rreth 7.2 milionë euro.

Kurse vetëm në vitin 2017 investimet e shtetit turk në Kosovë, sipas shifrave zyrtare, kanë qenë rreth 30 milionë euro, të dhëna këto që Turqinë e radhisin si shtetin e katërt me vlerën e investimeve, pas Gjermanisë, Zvicrës dhe Britanisë së Madhe. Qytetarët e Kosovës, përveç bashkëpunimit tregtar, Turqinë e konsiderojnë si një vend atraktiv turistik, sidomos gjatë sezonit veror.

Përfaqësues të operatorëve turistikë në Kosovë thonë se në dy muajt e fundit është rritur kërkesa e qytetarëve të Kosovës për të udhëtuar në Turqi, konkretisht në bregdetet. Pavarësisht prej kësaj, Vetiola

Reçica nga agjencia turistike "Eurokoha" ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se deri më tani klientët nuk kanë vërejtur lëvizje të çmimeve. "Zhvlerësimi i lirës realisht nuk ka ndikuar në çmimin e hoteleve për shkak se hotelet janë rezervuar më herët me çmimet që kanë qenë më herët dhe për shkak të rritjes së madhe të kërkesës për të udhëtuar në Turqi, çmimet nuk kanë lëvizur", është shprehur Reçica.

Sipas të dhënave të Ambasadës së Kosovës në Ankara, në Kosovë operojnë rreth 300 kompani turke dhe prej tyre 11 janë kompani të mëdha. Disa prej kompanive turke më të mëdha që operojnë në Kosovë janë Enka, Limak, Çalik dhe Banka Ekonomike Turke (TEB).

ATK-ja takon përfaqësuesit e ShKÇAK-ut



PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësues nga Shoqata e Kontabilistëve të

Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) për të diskutuar rreth bashkëpunimit me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve profesionale në fushën e kontabilitetit,

edukimin e vazhdueshëm profesional, organizimin e seminareve dhe kampanjave edukative për raportimin e drejt financiar si aktivitete të rëndësishme për përmbushjen tati-

more. Po në këtë takim palët u pajtuan që bashkëpunimi të vazhdojë si dhe të zgjerohen në periudhat e ardhshme. Takime të ngjashme si ky i fundit zhvillohen në vazhdimësi, pasi

motoja e përgjithshme e punës së ATK-së qëndron në krijimin e një mjedisi, i cili mbështet fuqimisht përmbushjen e detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve.

Matoshi kërkon ndihmën e Bankës Botërore për investime në sektorin e ujit



PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, të mërkurën është takuar me ushtruesin e detyrës së menaxherit të Bankës Botërore për Kosovë, Diego Garidd, specialistin për menaxhimin e burimeve ujore, TTL, Pieter Waalewijn, specialistin për menaxhimin e burimeve ujore, CO TTL, Trandelina Baraku dhe special-

istin e Lartë të Mjedisit, Javaid Afzal. Gjatë këtij takimi është diskutuar për ecurinë e projektit të Bankës Botërore për mbrojtjen e ujit dhe projektit për kanal in e Ibër - Lepencit si dhe janë prezantuar të gjeturat e raportit të studimit mbi "Gjendjen e sigurisë së ujit në Kosovë" (Water Security Outlook).

Ministri Matoshi me këtë rast ka pohuar se Kosova ka nevojë për partnerë dhe donatorë të cilët

mbështesin projektet për mbrojtjen e ujit, në veçanti ka kërkuar që MMPH-ja të ndihmohet në projektet që kanë të bëjnë me ndërtim të pendëve të ujit. "Kemi nevojë si shtet për ndërtimin e ujëmbledhësve dhe shtimin e numrit të pendëve të ujit. Këtu na duhet mbështetja e Bankës Botërore që të sigurojmë ujë të mjaftueshëm për vendin tonë, andaj jemi të interesuar të hyjmë në projekte konkrete për ndërtim

të pendëve të ujit", është shprehur Matoshi.

Ndër të tjera, ai ka siguruar përfaqësuesit e Bankës Botërore se MMPH-ja është e gatshme t'i kryejë të gjitha obligimet në projektin e kanalit të Ibër - Lepencit. Ndërsa ushtruesi i detyrës së Menaxherit të Bankës Botërore për Kosovë, Diego Garidd, ka theksuar se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka rol kyç në projektet e Bankës Botërore.

"Vitin e kaluar kemi aprovuar strategjinë tonë shumëvjeçare që është korniza për partneritet me vendin me tri shtylla, njëra prej të cilave është e lidhur me çështjen e mjedisit. Kemi disa projekte që prekin përgjegjësit dhe punën që bën Ministria e Mjedisit. Jeni ministria kyçe për ne dhe Banka Botërore është e interesuar ta vazhdojë këtë bashkëpunim dhe presim prioritetet tuaja në këtë fushë", ka deklaruar Garidd.

Ulet konsumi i energjisë elektrike për 6.7 për qind

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Bilancin e Energjisë" për TM2 2018. Në këtë publikim janë prezantuar të dhënat mbi

prodhimin e thëngjillit, të dhënat për prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018 (TM2 2018) vlera e

gjithëmbarshme e prodhimit të thëngjillit ishte rreth 1.64 mijë tonë, kurse sasia bruto e energjisë elektrike, e prodhuar në termocentrale ishte 1 402.5 GWh e në hidrocentrale rreth 118.1 GWh.

Sa iu përket vlerave të energjisë

së importuar, respektivisht të eksportuar, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018 Kosova ka importuar 23.0 GWh energji elektrike, derisa gjatë së njëjtës periudhë Kosova ka eksportuar 344.2 GWh energji elektrike.

Në tremujorin e dytë të vitit

2018 sasia e energjisë elektrike për konsum ishte 1 136.7 GWh energji elektrike. Në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM2 2017), sasia e energjisë elektrike të konsumuar është ulur për 6.7 për qind.

Prishtina lanson platformën për kontrata të hapura

Prishtinë, 15 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije të mërkurën se është lansuar platforma për kontrata të hapura përmes së cilës qytetarët mund ta shohin secilën kontratë, publikim dhe projekt. Ahmeti për ndihmën e kësaj platforme ka falënderuar Open Data Kosovo, Girls Coders Kosova, UNICEF, ADA e Innovations Lab Kosovo.

Ai ka thënë se kjo platformë ka edhe modulën e menaxhimit që u mundëson zyrtarëve të komunës që tërë kohën ta kenë pasqyrën e krejt kontratave në komunë dhe vonesave që mund të paraqiten. "Meqë jemi institucioni i parë në Kosovë që zhvillojmë platformë të tillë, i ftojme të tjerët të na bashkëngjiten në këtë rrugë të përbashkët", ka thënë Ahmeti.



Bekim Jashari: Jam i hapur me këdo për të bashkëpunuar

SKENDERAJ, 15 GUSHT (ER) - Komuna e Skenderajt ka vazhduar edhe të mërkurën ciklin e dëgjimeve buxhetore me publikun, kësaj radhe me banorë të qytetit dhe përfaqësues të lagjeve të fshatit Klinë e Poshtme. Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se vetëm

në këtë mënyrë, duke marrë pjesë në dëgjime buxhetore, si institucione lokale dhe si qytetarë, bëhemi bashkëhartues të buxhetit për vitin e ardhshëm si dhe të planifikimeve për vitet e tjera 2020-2021. "Kam premtuar transparencë të plotë dhe do të jem i hapur me këdo për të

bashkëpunuar në të mirë të qytetarëve të Komunës së Skenderajt pa dallim. Një falënderim për të gjithë ata qytetarë që ishin sot në sallën e Kuvendit Komunal të Skenderajt, të cilët kontribuuan me kërkesa reale", ka thënë Bekim Jashari, kryetar i Komunës së Skenderajt.



300 mijë euro për infrastrukturën rrugore të Pejës

Pejë, 15 gusht (ER) - Zëvendësministri i Infrastrukturës, Rexhep Kadriu, dhe nënkryetari i Komunës së Pejës, Shkumbin Gashi, kanë nënshkruar një memorandum për financimin e projekteve infrastrukturore për qytetin e Pejës në vlerë 315 mijë euro. Gjithashtu, u

përditësuan edhe marrëveshjet paraprake, 2016 dhe 2017, me të cilat garantohen mjete financiare për projektet të cilat janë në realizim e sipër.

Disa nga projektet që Ministria e Infrastrukturës ka planifikuar t'i realizojë gjatë këtij viti në Pejë janë: Asfaltimi i rrugës Bogë-

Shkrel-Koshutan-Molika e Sakut, asfaltimi i rrugës Maja e Zezë-Peklen-Shtypeq i Vogël-Varri i Sykut, asaj në Drelaj-Llutov-Pepaj, Gllaviqicë-Vragoc, si dhe ndërtimi i rrugës Novosellë-Lipë. Kadriu dhe Gashi biseduan edhe për problemet dhe vështirësitë e përgjithshme rrugore të Pejës.

Shoqata e Transportuesve të Prizrenit kërkon t'i lejohen linjat nëpër autostradë

Prizren, 15 gusht (ER) - Shoqata e Transportuesve të udhëtarëve "Kosova e lirë" nga Prizreni ka njoftuar se sot (e enjte) do të protestojnë të gjithë operatorët që mbajnë linjën Prishtinë - Prizren. Ata në letrën informuese kanë kundërshtuar

vendimin që vetëm një operator ta mbajë këtë linjë përmes autostradës, duke kërkuar që secilit prej tyre t'u lejohet nga një e tillë. Ata thonë se, siç qëndron situata tash, mund të shpie edhe te përplasjet fizike mes operatorëve.



Kompania "Pastrimi" bëhet me 10 kamionë të rinj

Prishtinë, 15 gusht - Kompania rajonale për menaxhimin e mbeturinave "Pastrimi" është bërë me

dhjetë kamionë të rinj, të cilët do ta lehtësojnë punën në menaxhimin e mbeturinave. Me këtë rast, komunat që

marrin shërbime nga kjo kompani janë pajisur me nga një kamion të ri, ndërsa Komunës së Prishtinës i janë dhënë pesë

të tillë. Kjo është bërë me të hyra vetjake të kompanisë "Pastrimi", që ndodh për herë të parë.



FASHIZMI DHE RACIZMI I LDK-së SI DHE OPORTUNIZMI KLIENTELIST I SHOQATËS SË TË BURGOSURVE POLITIKË (2)



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Edhe gjatë të pamës pati përpjekje për protagonizëm nga një numër i caktuar personash që donin të përfitonin politikisht edhe nga kjo ceremoni e që ishte veprim jashtëzakonisht i ulët që shkon më së miri me pamoralin e tyre. Një gjë më bëri përshtypje: nuk kaloi as edhe një javë e plotë dhe Shoqata klienteliste e të Burgosurve Politikë ndau "mirënjohje" për ata që, sipas saj, ishin afër Bacës në kohët më të vështira për Bacën dhe që u kujdesën për të. Krejtësisht e pavërtetë dhe lista kishte emra që Baca as nuk ka dashur t'i ketë afër për së gjalli. Duhet të theksohet se pas përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të Bacës Adem, barra kryesore i ka rënë familjes së Bacës ngaqë institucionet merreshin me punë të tjera. Realisht, për Bacën gjatë qëndrimit në QKUK më së shumti janë përkujdesur Curr Gjocaj dhe prof. dr. Nexhmedin Shala dhe shumë faleminderit. Natyrisht se familja e ka bërë përpjekjen maksimale që të jetë afër Bacës që është e kuptueshme, mirëpo dua ta theksoj angazhimin e jashtëzakonshëm të Arbërie Demaçit, gruaja e Shqiptarit dhe bija e ish të burgosurit politik dhe aktivistit të dalluar për çështje kombëtare, tash të ndjerit Ibrahim Gashi.

Po të bëheshim bashkë të gjithë ne që kemi qenë afër Bacës, nuk do të kontribuonim as për së afërmi sa ka kontribuar Arbërie Demaçi. Është e pabesueshme sakrificat e Arbëries për Bacën dhe nga jashtë askush nuk do të besonte se një re mund të bëjë aq shumë për vjehrrin. Sa për informatë shokët që i kanë

ndenjtur afër Bacës në kohën kur të tjerët ngarendnin pas posteve dhe privilegjeve nuk janë ata të listës së Shoqatës, përjashtuar të ndjerin Shashivar Makollin, që ka qenë shofer i Bacës dhe shoqërues i tij në situata më të rrezikshme, pa përfituar as edhe një cent të vetëm. Shtëpia e Shashivarit ka pasur dyer të hapura 24 orë për Bacën dhe të gjithë kanë qenë në shërbim të Bacës. Shashivari ka qenë shofer, shoqërues dhe roje e Bacës në kohët më të vështira, para, gjatë dhe një periudhë pas përfundimit të luftës duke e vënë jetën në rrezik tërë kohën.

Xhelal Pakashtica, i "dekoruar" nga Hydajeti me kompani, ka qenë shofer i paqes, shoqërues i qejfeve, drekave dhe darkave sikur që ka marrë rrogë nga Qeveria e Kosovës për këtë. Pa rrezikuar kurrë dhe asgjë. Selatin Novosella është promovuar si biograf i jetës së Bacës dhe nuk më kujtohet t'i ketë qenë afër në kohë të vështira e lëre më të ketë bërë çfarëdo lloj sakrifice. Hetem Ramadani ka qenë "mik nga distanca" dhe kam bindjen se më shumë ka bërë Baca për Hetemin, se Hetemi për Bacën. Dhe, i fundit nga "Lista e Shindlerit" të ShBP është Skender Kastrati që e ka respektuar Bacën në maksimum, ka qenë zëvendës i Bacës në Zyrën e Përfaqësuesit Politik të UÇK-së sepse përmbajtja kombëtare e Skenderit ka qenë e tillë që nuk ka mundur të veprojë ndryshe, mirëpo Skenderi nuk ka pasur mundësi, për shkaqe objektive, të jetë afër Bacës për një kohë të gjatë. Ka pasur të tillë që krejtësisht pameritueshëm kanë përfituar edhe statusin e veteranit të luftës duke e keqpërdorur Bacën, ndonëse as edhe një petardë nuk e kanë ndezur për luftën dhe nuk e kanë dhënë as edhe një fening të vetëm kurse, më lirshëm kanë hyrë në stacionin policor të policisë serbe në Prishtinë se në Zyrën e UÇK-së në Prishtinë. Me këto çështje mund dhe do të merrem më vonë sepse kërkon kohë dhe hapësirë më shumë. Baca

Adem ka pasur shokë të shpirtit dhe të idealit Rexhep Dalldurin, Ahmet Haxhiun kurse, pas daljes nga burgu e deri te fillimi i luftës, Bacën Adem e kanë mbuluar 24 orë dhe e kanë përkrahur në çdo aspekt Abdullah Dërguti apo Dul Taraku, Nuhi Ashmeti apo Llapqini dhe Shashivar Makolli apo Shasha. Baca i ka dashur shumë Fehmi Lladrovcin apo Zharavën, Xhevë Lladrovcin apo Shotën, Sylejman Selimin apo Sulltanin, Kadri Veselin apo Lulin, Hafir Shalën apo Filin, Haki Gashin apo Doktorin, Tahir Hanin apo Zhidovin, Elmi Reçicën dhe sidomos Binak Dinajn apo Nakun e cili e humbi krahun në Betejën e Logjës kur dezertoi "koloneli" i UDB-së dhe KOS-it. Pas luftës politikanët aktualë e donin shumë Bacën me kusht të mos përziheshin në politikë. Sa më larg të qëndronte Baca larg politikës, "dashuria" ndaj Bacës rritej. Bacën e ka respektuar shumë edhe Sejdi Gegaj dhe të tjerët që nuk po mund t'ua përmend emrat e të cilët do t'i përfshij në shkrimet e radhës. Kjo është, sa për fillim. Shëngjini i Behxhetit apo Shëngjini i Begjetit: Edhe unë isha në Shëngjin me Fexhën, Shkëmbin, Blinin, Agimin, Anën dhe Yllin. Njerëz të shpirtit dhe të zemrës që i dua shumë. Më munguan shumë Hashimi, Begjeti dhe Batoni. Janë njerëz të thjeshtë, patriotë të vërtetë, modestë, shumë të ndershëm, sakrifikues e që e kanë fituar simpatinë e tre kosovarëve dhe tre ish-shqiptarëve. Nga plazhet për vdekatarë të rëndomtë si Brigeni, Kristi dhe Sigma vërehet një jaht superluksoz që nuk ishte i qasshëm për ne dhe për të cilin flitej se është bërë fole e ahengjeve të frenuara dhe modeste të El Hashim bin Begjet pec Batonit, kombësia e të cilëve mbetej e papërcaktuar. Dikush thoshte se janë nga Dubai ku kanë prona të shumta, dikush thoshte se janë nga Kazakistani i Putinit, kurse dikush thoshte se janë puthadorët e Mrezovicës. Po ta dija e që më vonë mora vesh se ishin treshi më i dashur në

Kosovë dhe më i respektuari te Vuçiqi, edhe po të përballesha me 100 peshkaqen gjigantë, do të notoja drejt jahtit, jo për të hyrë brenda, se kjo është jashtë imagjinatës e lëre më mundësive reale por, së paku, nëse do të mbijetoja do t'i shihja nga afër, do të shihja bermudet rumbullake me lule të Gjetit, trupin prej Posejdoni me afat të skaduar të Pehlivanit dhe shtatzëninë e vonshme të kurvërisë politike të Faton Haxhillarit. Definitivisht këta janë të pamoralshëm, të pandjeshëm, të pacipë dhe të pangopshëm. Janë të pashpresë dhe të vdekur, njerëzisht, moralisht, politikisht dhe kombëtarisht. Të shahen aq ulët, me fjalët më të ndyra dhe akuzat më të poshtra të mundshme e që pastaj të shkërdhohen së bashku në shtratin e quajtur Jahti i Gjetit, si do ta komentoni ju lexues të nderuar! Edhe imoraliteti duhet ta ketë një kufi sikur edhe poshtërsia!

"Dorëheqja" e Albenës sikur afera e Valbuenës: Karim Benzema e humbi vendin në reprezentacionin e Francës sepse dyshohej që me një tjetër person ka bërë incizime intime të jetës së futbollistit francez Valbuenës, pastaj e kanë shantazhuar. Albena Reshitaj ka qenë dhe është një zonjë shumë inteligjente, shumë e sjellshme, shumë e mençur dhe shumë sharmante. Ka komunikim me plot sharmë dhe kulturë, pikëpamje moderne, por që nuk ka harruar traditën. Më ka lënë përshtypje shumë pozitive gjatë një takimi me të. Pastaj, dëgjova se ka dhënë dorëheqje "për shkaqe personale". Kjo "për shkaqe personale" është faturë për të gjitha dorëheqjet e imponuara dhe, me këtë përfundon tregimi. Kam përshtypjen se ka qenë e detyruar sepse koeficienti i saj i inteligjencës nuk është përputhur me atë të Rrahës dhe Gjetit. Te ne mbizotëron një bindje se, nëse keni para, pavarësisht si i keni fituar ato, me ato para mund ta blini mendjen, shpirtin, zemrën, trupin apo dashurinë e dikujt. Idiotizëm është kjo bindje.

Mund ta blini trupin, mund ta blini mendjen e intelektualëve që hyjnë si supositorij në prapnicën e të kamurve injorantë dhe debilë, por kur nuk do ta blini zemrën, shpirtin dhe dashurinë e tjetrit. Albenë, në luftë kundër injorantëve, e ke përkrahjen time. Aq kam mundësi!

Çka kanë të përbashkët dhe ku dallojnë Morena Taraku dhe Hashim Thaçi: Së pari për pikat e përbashkëta dhe dallimet. Kohët e fundit që të dy janë aktivë në raport me publikun, Morena në rrjetet sociale, Hashimi në konferencat për media. Që të dy, si kostum të larjes e përdorin toplesin duke mbuluar vetëm, Morena, Bregun e Venerës, Hashimi kaçubat e Vlorës. Morena ka më shumë aktivitete mbitokësore, Hashimi kryesisht nëntokësore. Morena, atë që ju premtion, ka mundësi t'jua japë, kurse Hashimi atë që e premtion kurrë nuk do ta keni. Morena ka rënë në dashuri me Sashën, Hashimi me Bacën. Morenën e modelojnë kirurgët, juve ju prenë Hashimi, ndonëse nuk është kirurg. Morena e ka shkelur Iranin, Hashimi nuk po guxon ta shkelë veriun e Kosovës. Morena, sa më shumë që lakuriqësohet bëhet më shumë atraktive, Hashimi sa më shumë që lakuriqësohet bëhet më misterioz.

Morena më shumë ka mundësi të bëhet mbretëreshë e Samarkandit sesa që Hashimi do ta kthejë Luginën e Preshevës. Hashimi nuk e ka shkelur veriun, dy-tre goranë nuk e lënë të shkojë në Dragash gjatë festave fetare dhe shtetërore të Serbisë, Pop Sava nuk e lë ta ndërtojë rrugën sepse ua prishë rehatinë popave dhe popadive të Manastirit të Deçanit. Morena ia jep Sasha Sopianit, Hashimi i ka lëshuar brekët para Llabanit. Kjo ishte në pika të shkurta... të gjata pikëpamja ime për disa zhvillime në Kosovë sa isha në Shëngjin. Çfarë paradoksi, unë si mysliman shkova për pushime në Shëngjin, Leka, si i krishterë, shkoi në pushime në Turqi. (Fund)

Erdogani bisedon me Merkelin

ANKARA, 15 GUSHT - Presidenti i Turqisë Rexhep Tajip Erdogan zhvilloi bisedë telefonike me kancelaren gjermane Angel Merkel. Sipas burimeve diplomatike, në bisedën telefonike dy liderët kanë këmbyer mendime rreth marrëdhënieve dypalëshe dhe çështjeve rajonale në krye me Sirinë, raporton agjencia turke e lajmeve. Në bisedë, në të

cilën janë diskutuar zhvillimet aktuale, është përmendur edhe takimi që do të realizohet në Berlin në fund të shtatorit mes presidentit Erdogan dhe kancelares Merkel.

Erdogani dhe Merkelin kanë rënë dakord për një takim mes ministrit turk të Thesarit dhe Financave, Berat Albayrak dhe ministrit gjerman të Financave

dhe Ekonomisë në ditët në vijim. Po ashtu, Merkelin ka theksuar se është e rëndësishme për Gjermaninë që ekonomia e Turqisë të jetë e fuqishme. Liderët kanë konfirmuar vendosmërinë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit reciprok në mes të Turqisë dhe Gjermanisë përmes vizitave dhe kontakteve të nivelit të lartë.



Turqia, tensionimi i marrëdhënieve me ShBA-në dhe kriza ekonomike

Tensionet me Uashingtonin dhe kriza ekonomike kanë bërë që Turqia ta shqyrtojë mundësinë e forcimit të lidhjeve me Rusinë dhe të gjejë aleatë të rinj në Lindjen e Mesme. Monedha turke ka humbur rreth 40 për qind të vlerës së saj këtë vit kundrejt dollarit amerikan

ANKARA, 15 GUSHT - Nuk ka shenja të ngadalësimit të ritmit të përkeqësimit të marrëdhënieve mes Shteteve të Bashkuara dhe aleatit të saj të NATO-s, Turqisë, për shkak të refuzimit nga Ankaraja të kërkesës së Uashingtonit për lirim të një pastori amerikan të ndaluar nën akuzat për spiunazh. Departamenti Amerikan i Thesarit në fillim të këtij muaji vendosi ministrin e Drejtësisë dhe ministrin e Brendshëm të Turqisë në listën e sanksioneve në përgjigje të mbajtjes në arrest të pastorit amerikan. Burimet e administratës thonë se po shqyrtohen mundësitë e vendosjes së sanksioneve të mëtejshme. Turqia po e mban në arrest shtëpiak pastorin Andrew Brunson në pritje të gjyqit të tij. I ngarkuari më punë në Ambasadën Amerikane në Turqi, Jeffrey Hovenier, vizitoi pastorin Brunson të martën. "Ne vazhdojmë t'u bëjmë thirrje autoriteteve turke që rasti i pastorit, rastet e

amerikanëve të tjerë dhe punonjësve turq të misionit diplomatik të Shteteve të Bashkuara të ndaluar padrejtësisht të zgjidhen pa vonesë, në mënyrë të drejtë dhe transparente. Këtë kërkon qeveria ime", tha ai.

Zëdhënësi i presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan, Ibrahim Kalin, tha të mërkurën se Ankaraja do t'i vazhdojë bisedimet me Shtetet e Bashkuara nëse Uashingtoni mban një qëndrim konstruktiv. "Administrata amerikane duhet ta respektojë procesin gjyqësor në Turqi. Ata duhet t'i ndalin përpjekjet për të ndikuar mbi sistemin turk të drejtësisë duke bërë deklarata dhe duke ushtruar presion. Kur të ndodhë kjo, marrëdhëniet tona do të normalizohen dhe do të hapet një faqe e re në marrëdhëniet turko-amerikane", tha Kalin.

Mosmarrëveshjet në rritje mes dy vendeve kanë përkeqësuar krizën ekonomike të Turqisë, duke



shkaktuar rënien e lirës. Monedha turke ka humbur rreth 40 për qind të vlerës së saj këtë vit kundrejt dollarit amerikan. Presidenti turk Erdogan u ka bërë thirrje turqve t'i shkëmbejnë dollarët për lirën për ta ndihmuar monedhën vendëse. Administrata e presidentit Trump të premtet dyfishoi tarifën mbi importet turke të aluminit dhe çelikut. Presidenti turk Erdogan e quajti këtë një "luftë tregtare" dhe "një sulm pas shpine ndaj Turqisë" nga aleati i saj i NATO-s. Ai të martën njoftoi se Turqia do t'i bojkotojë produktet elektron-

ike amerikane.

Analistët besojnë se përkeqësimi i marrëdhënieve në mes të Turqisë dhe Shteteve të Bashkuara është rezultat edhe i mosmarrëveshjeve mbi çështjen e Sirisë, refuzimin nga Uashingtoni për ekstradimin e klerikut Fetullah Gulen, të cilin Ankaraja e fajëson për grushtshtetin e dështuar të vitit 2016, dhe blerja nga Turqia e raketave ruse S-400.

Tensionet me Uashingtonin dhe kriza ekonomike kanë bërë që Turqia ta shqyrtojë mundësinë e forcimit të lidhjeve me Rusinë

dhe të gjejë aleatë të rinj në Lindjen e Mesme. Presidenti turk Erdogan ka zhvilluar një bisedë telefonike me homologun rus Vladimir Putin për të diskutuar bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik. Ndërkohë të hënën, ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov vizitoi Turqinë, ku tha se dy vendet do të ndër marrin hapa për "një partneritet më të madh strategjik". Analistët besojnë se këto janë shenja se Rusia dhe Turqia po shtojnë bashkëpunimin për t'i zbutur pasojat e sanksioneve amerikane.

Ulet numri i sulmeve terroriste në nivel global

UASHINGTON, 15 GUSHT - Numri i sulmeve terroriste në botë është ulur dukshëm gjatë vitit 2017. Sipas të dhënave të Universitetit Maryland me seli në Shtetet e Bashkuara, gjatë vitit 2017 kanë ndodhur 11 mijë sulme terroriste, që paraqet ulje të numrit të sulmeve në krahasim me vitin 2014 ku kishin ndodhur 17 mijë sish. Megjithatë grupi militant Shteti Islamik mbeti grupi më aktiv që ka kryer sulme terroriste gjatë vitit 2017, ky grup ka

kryer 10 për qind më pak sulme dhe ka shkaktuar 40 për qind më pak vdekje krahasuar me vitin 2016.

Grupi terrorist IS arriti kulmin në vitin 2014, kur bëri përparime në Lindjen e Mesme, duke pushtuar qytetet si Raka në Siri dhe Mosul në Irak. Ata morën përgjegjësinë për një seri sulmesh vdekjeprurëse në Evropë dhe më gjerë.

Me gjithë përmirësimin në nivelin global, disa vende të veçanta regjistruan më shumë

raste të terrorizmit sesa më parë. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 91 persona u vranë në vitin 2017, ose përkthyer në shifra, kjo paraqet një rritje prej 49 përqindësh.

Turqia ka pasur një ulje prej 67 përqindësh të sulmeve terroriste, gjithashtu edhe numri i vdekjeve është ulur për 78 për qind. Në Jemen numri i sulmeve terroriste është zvogëluar 57 për qind dhe numri i vdekjeve është zvogëluar për 50 për qind.



(Reagim përkitazi me iniciativën e kryeparlamentarit të Kosovës, Kadri Veselit, për zhvendosjen e eshtrave të Hasan Prishtinës nga Kukësi në Prishtinë)

HASAN PRISHTINA E KA VENDIN ATY KU BASHKOHET KUFIRI DHE IDETË E KOMBIT SHQIPTAR



Mehmet PRISHTINA

Në 85-vjetorin e vrasjes së patriotit shqiptar, udhëheqësit të kryengritjeve për liri, diplo-

matit të shquar e ish-kryeministrit të Shqipërisë, Hasan Prishtina, liderët e institucioneve të Kosovës do të duhej të angazhoheshin që hapësira tek varri i Hasan Prishtinës në Kukës, në qytetin kufi në mes të Shqipërisë së ndarë, të rregullohej e të ndërtohet edhe muzeu i madh i bashkimit kombëtar.

Ata duhen që bashkë me institucionet e shtetit shqiptar të kujdeseshin që në Vlorën e pavarësisë, krahas shtatoreve të Ismail Qemalit, Isa Boletinit

e të tjerëve patriotë, të vendoset edhe Hasan Prishtina në sheshin e flamurit, siç u vendos në Prishtinë e më vonë edhe në Shkup e Tiranë dhe, përfundimisht, në qytetin shqiptar në Kukës të derdhet në bronz shtati i shenjtë e i shtrenjtë i Hasan Prishtinës, pasi aty afër e ka edhe varrin, e jo të tallen në "Facebook" për kthimin e eshtrave të tij në Kosovë.

Hasan Prishtina mbetet një ndër të rrallët patriot shqiptar që me veprën dhe të kaluarën

e vet vazhdon t'i bashkojë edhe sot shqiptarët, përtej bindjeve politike, ideologjike, fisnore e inatçore të popullit tonë, prandaj çdo nismë për t'ia lëvizur eshtrat atij, është vetëm thellim i ndarjes së shqiptarëve dhe mosrespekt e mosnderim ndaj figurës dhe doktrinës së tij hasaniste.

Hasan Prishtina është i Shkupit, i Tiranës, i Prishtinës, i Plavës e Gucisë, i Shkodrës e i Vlorës, i Prevezës, i Manastirit, i Ohrit e i Tetovës, i Preshevës e i Pazarit të Ri. Ai është i gjithë

neve që Shqipërinë e plotë e ndiejmë në mendje dhe zemër. Por, ashtu siç luftoi Hasan Prishtina për t'i rrëzuar muret ndarëse midis shqiptarëve, edhe unë bashkë me familjen e madhe, me shumë miq e shokë nga të gjitha anët e botës, kërkojmë të mos lëvizet nga varrezat e dëshmorëve të atdheut që prehet në qytetin e Kukësit!

(Autori është përfaqësues i familjes së Hasan Prishtinës. Prishtinë, 15 gusht 2018)

TEHU I DËSHPËRIMIT, DREJT FUNDIT



Nga Musa SABEDINI

Nuk do të shkojë fort larg dhe këta politikanët tanë dhe qeveritarët e tanishëm do të flasin sikur në ëndrra dhe do të detyrohen të gënjejnë e të shpikin lloj-lloj mashtrimi, vetëm që të shpëtojnë nga zemërimi dhe tehu i dëshpërimit qytetar që, si duket, është kah fundi. Tani po dëgjojmë propozime nga më të ndryshmet, derisa qëllimi i tyre përfundimisht është krijimi i

një Kosove "qesharake" sepse ndryshe nuk mund të kuptohet kjo politikë pa shije, pa kreativitet dhe pa njohje elementare të diplomacisë. Në Shqipëri përdoren shumë salatat çobane. Ndoshta kjo shprehje më së miri u përgjigjet "çobanëve" tanë të cilët nga zori dhe nga halli i tyre, po bëjnë gjeste të paekuilibruara në raport me publikun.

Nuk është aspak befasuese që në ditët e ardhshme të dëgjojmë, të shohim e të përrjetojmë rrena nga më të ndryshmet, propozime nga më të çoroditurat. Dhe, pse po ndodh kjo?

Politika e Kosovës ka gënjyer mjaft, ka manipuluar mjaft me ndjenjat e qytetarëve të saj. Tani është fundi ose jemi në tehun e dëshpërimit. Qytetarët nuk do të kenë kohë të mjaftueshme për t'u marrë me gënjeshtat e qeveritarëve, por

as të opozitës, e cila tërë kohën është marrë dhe po merret me problemet periferike.

Hashim Thaçi nga "sikleti" çdo ditë po thërret konferenca shtypi, Ramushi ndërkaq çdo ditë po bën gafe të llojeve femijerore. As politikanët e tjerë nuk janë stabilë, kurse opozita po sillet shumë naive karshi gjendjes në të cilën ndodhet Kosova. Nuk pajtohem me konstatimet, nga më të ndryshmet, se Hashim Thaçi po e bën këtë lojë për ta shpëtuar veten nga Specialja. Kjo nuk qëndron, sepse u bënë gjashtë vjet që është folur e përfolur se Thaçi do të shkojë këtu e atje, por nuk ndodhi asnjëra dhe, unë nuk besoj se Thaçi do të gjykohej, por presidenti i vendit mund të përballet me zemërimin qytetar.

Por, cili është sikleti ose halli që kanë pothuajse të gjithë liderët

tanë, duke mos përjashtuar këtu as Gjergj Dedajn, i cili foli përçarje dhe pa fije sensi e shije, derisa pret të bëhet ambasador në një vend ku klima myslimane është në rritje dhe në përkrahje të qeveritarëve aktualë në Turqi.

Liderët tanë, si ata shtetërorë, ashtu edhe ata opozitarë, do të nxjerrin nga mendjet e tyre çdo ditë propozime qesharake. Ndodhi propozimi me Luginën, pastaj doli Ujmani, ndërkohë Kadri Veseli merret me eshtrat e Isa Boletinit. Pra, janë ide dhe koncepte krejt të kundërta me atë që çdo ditë ka folur dhe ka propaganduar klasa politike. Pra, këto propozime të çoroditura synim kanë largimin e publikut nga liberalizimi i vizave, i cili nuk do të ndodhë këtë vit, nga krijimi i vendeve të reja të punës, krijimi i Ushtrisë së Kosovës dhe mba-

jtja e zgjedhjeve të reja.

Unë personalisht mendoj se kjo garniturë politike, pozitë dhe opozitë, do ta ketë të vështirë ta çojë përpara Kosovën në agjendën e saj evropiane. Gjasat që Kosova të mbetet stabile në arenën ndërkombëtare janë të pakta, ndërsa publiku i shumtë që frekuenton nëpër rrjetet sociale, preokupim kryesor e ka aspektin fetar, problemet e brendshme të Turqisë dhe politizimin e luftës së fundit.

Për të ndodhur e kundërta, institucionet e Kosovës kanë për obligim ta thonë të vërtetën, ndërsa Kuvendi i Kosovës, që llogaritet ndër më të dobëtit në periudhën e pasluftës, duhet të bëjë trysni te klasa politike dhe te vetvetja që marrëveshjet eventuale në mes të Kosovës dhe Serbisë të jenë publike për qytetarët.

Haziri zotohet për mbështetje maksimale për teatrin e Gjilanit

GJILAN, 15 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur të mërkurën në takim pune drejtorin e teatrit profesionist të qytetit, Erson Zymberi, dhe kryetarin e Shoqatës Sindikale të Teatrit, Naser Zymberi.

Gjatë këtij takimi është diskutuar lidhur me kalendarin e aktiviteteve të teatrit dhe për

buxhetin për vitin 2019. Haziri në këtë takim ka shfaqur zotimin për mbështetjen maksimale për teatrin profesionist të qytetit me të gjitha kapacitetet komunale. Ndërkaq drejtori i teatrit, Erson Zymberi, dhe ai i sindikatës, Naser Zymberi, kanë falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe zotimin e tij për përkrahje.



Krijues dhe inteligjentë, kush janë “Vip”-at mëngjërashë!

Nga Obama te Bill Gates dhe nga Bob Dylan te Valentino Rossi, ja VIP-at që përdorin dorën e majtë.

Ata janë përndjekur për shekuj me radhë dhe paragjykimet kundër tyre nuk janë zhdukur plotësisht sepse, edhe sot, objektet e përdorimit të përditshëm nuk janë menduar kurrë për njerëzit me dorë të majtë. Etimologjia e fjalës nuk çon në konsiderimin e përdorimit mbi-zotërues të dorës së majtë në një mënyrë pozitive.

Mjafton të thuhet se fjalori Treccani shpjegon se, në kuptimin figurativ, termi mëngjarash përdoret për të treguar një veprim të padrejtë dhe të fshehtë, të kryer me dinakëri dhe të paparashikueshëm. Referuar njerëzve është përdorur për të kategorizuar dikë si pabesë dhe të pandershëm. Dhe ka më shumë, termi vjen nga latinishtja 'mancus': sinonim i gjymtuar. Në frëngjisht, 'qu'il est gauche' është përdorur për të thënë 'sa i ngathët'.

Në spanjisht 'no serbe' do të thotë 'të mos jetë mëngjarash', por edhe 'të jetë inteligjent'. Në greqisht, për të thënë mëngjarash ne përdorim 'skaiois', i cili ndër kuptimet e saj gjithashtu ka atë të pafat. Në gjermanisht, dy termat që tregojnë njerëzit me dorën e majtë identifikojnë gjithashtu një individ të ngathët.

Së fundi, kishte shkencëtarë që madje pohonin se të qenit mëngjarash ishte një kusht i trashëguar, sikur të ishte një

sëmundje. Dora e majtë vazhdon të quhet 'dora e djallit' dhe mësuesit në vitet e kaluara, ua lidhnin krahët nxënësve për t'i detyruar të shkruanin me dorën e djathtë. Dhe për t'u përpjekur për të kapërcyer këto paragjyime është menduar Dita Ndërkombëtare e Mëngjarashëve, një ngjarje e lindur në vitin 1976 në sajë të shoqatës angleze "Lefthanders International", e cila bie çdo 13 gusht. Por për të fshirë me një goditje çdo paragjykim ndaj atyre që kryesisht përdorin anën e majtë të trupit, pothuajse 10% e popullsisë së botës, do të ishte e mjaftueshme për të bashkuar emrat e njerëzve të famshëm mëngjarash, duke filluar me Gigi Riva të madh, një legjendë e futbollit, trajneri i të cilit Manlio Scopigno do të thoshte: "Rivës këmba e djathtë i shërben vetëm për të hyrë në tramvaj".

Për të vazhduar me Diego Armando Maradona, Johan Cruyff dhe John McEnroe me Ayrton Senna dhe kalorës Valentino Rossi. Dhe pastaj Bob Dylan, Paul McCartney, Paul Simon dhe i madh Jimi Hendrix, por edhe Charlie Chaplin. Dhe në qoftë se në mesin e piktorëve që ishin mëngjarashë Leonardo da Vinci, Michelangelo, Picasso, Van Gogh dhe Raphael duhet të besohet se teoria sipas së cilës kanë më të zhvilluar hemisferën e djathtë të



trurit (e cila kontrollon dorën e majtë) favorizon perceptimin e tre-dimensionalizmit, krijimtarisë dhe rrjedhimisht venën artistike. Dhe studimet në këtë temë nuk janë të pakta: sipas një studimi të Universitetit Shën Lawrence në Nju Jork, midis të gjithë njerëzve me një IQ të rëndësishëm, dmth super të zgjuar, do të kishte më shumë mëngjarashë se sa mesatarja e popullsisë.

Alan Salerman, autor i studimit, thotë se inteligjenca e mëngjarashëve është më fluide dhe se në këto individë ka një prirje më të madhe për të zgjidhur problemet.

Për këtë arsye Napoleon Bonaparte është një nga strategët më të mëdhenj ushtarakë në histori. Një hulumtim tjetër, këtë herë anglisht, i botuar në Nature Neuroscience ka treguar se njerëzit mëngjarashë janë sigurisht më të pajisur, nga këndvështrimi neurologjik, për artin oratorik: truri i tyre, në fakt, ndryshe nga ai i dorës së djathtë, përdor të dy hemisferat për përpunimin e gjuhës: një shembull për të gjithë është Barak Obama. Së fundi, një hulumtim i kryer nga Byroja Kombëtare e Kërkimeve Ekonomike ka treguar se në

Shtetet e Bashkuara njerëzit mëngjarashë kanë të ardhura 15% më të larta se ato me dorë të djathtë, duke zënë poste më të spikatura në kompani, për pasojë edhe paga më të larta: ky është rasti i Bill Gates, një ndër 3 burrat më të pasur në planet. Pra, pavarësisht nga këto karakteristika të rëndësishme, shpesh njerëzit me dorën e majtë vazhdojnë dhe vazhdojnë të jenë nën presion për të mësuar se si të përdorin dorën e tyre të djathtë, siç ishte geniu Albert Ajnshtajni, ku dora e djathtë ishte praktikë e asaj kohe.

gazeta-shqip.com




Çantat e Kylie Jennerit kapin vlerën një milion dollarë



Kylie Jenner ka treguar dollapin e vet të çantave. 21-vjeçarja i ka lënë pa fjalë të gjithë me koleksionin e veçantë dhe shumë të larmishëm.

Markat me të njohura të çantave ndodhen në dollapin e yllit. Mediet raportojnë se vetëm çantat e Kylie Jenner kapin vlerën një milion dollarë.



Rita kombinon punën me pushime

Këngëtarja Rita Ora është e angazhuar në shumë koncerte gjatë kësaj vere. Të fundit e ka mbajtur të martën në Maltë. Përpos punës, këngëtar-

ja e Kosovës me famë botërore po gjen kohë edhe për relaksim. Rita ka publikuar disa fotografi seksi në detin e mahnitshëm të Maltës.

Liam Payne shfaqet me të dashurën e re



Liam Payne u nda nga e dashura Cheryl vetëm gjashtë javë më parë. Çifti kishin një lidhje prej dy vjetësh dhe janë prindër të një djali. Mirëpo, duket se Liam e ka lënë

pas krahëve lidhjen me Cheryl. 24-vjeçari është fotografuar në Como, Itali, duke shkëmbyer puthje me të dashurën e re, Cairo Dwek. 20-vjeçarja Cairo është një modele amerikane.

Emma Stone tregon pse nuk i përdor rrjetet sociale



Aktorja e famshme Emma Stone do të jetë në ballinën e revistës së famshme "Elle" e cila do të publikohet në shtator të këtij viti. Gjatë kësaj interviste aktorja ka thënë se nuk i përdor rrjetet sociale pasi nuk i sheh

si diçka pozitive për të. "Unë mendoj se nuk do të ishte një gjë pozitive për mua. Ndoshta njerëzit e tjerë mund ta përballojnë atë lloj të prodhimit dhe kontributit në sferën e medieve sociale dhe fuqinë e saj", ka thënë Stone.

E jashtëzakonshme

14-vjeçari kandidon për guvernator të Vermontit

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) një nxënës 14-vjeçar ka vendosur t'i hyjë politikës duke kandiduar për postin e guvernatorit të Vermontit. I riu Ethan Sonneborn ka shfrytëzuar një veçanti të Kushtetutës së shtetit verilindor amerikan, që nuk vendos një limit të poshtëm moshe për të konkurruar për qeverisje. E vetmja kërkesë është të kesh jetuar për të paktën katër vjet në Vermont dhe Ethan ka lindur në këtë shtet.



BARSOLETA E DITËS



Niset drejtori i kopshtit zoologjik në një udhëtim zyrtar. Në gjysmë të rrugës, i telefonon sekretarës: - Shef, na ka ngordhur majmuni më i madh. A me porositë një tjetër a me të pritë ty?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Burrat ushtrojnë në një palestër publike në Spanjë. /AP/


Në ora 18:20

"FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info**, **www.kinoabc.info**, **fb: Kino ABC.**

E rrallë

Slovenët mblidhen për të thyer rekord në kositje

Mbi 570 qytetarë slovenë janë mbledhur në një zonë rurale të vendit për të vendosur një rekord të ri në librin "Guinness", për më së shumti njerëz që kositin së bashku në një arë. Kositja është metodë e vjetër e prerjes së barit duke përdorur një dru të gjatë me një thikë të madhe të lakuar në fund. Pjesëmarrësit në këtë ngjarje të paza-



kontë ishin të moshave të ndryshme nga 16 deri 88 vjeç. Secili kishte nga katër metra katrorë për t'i kositur.

 <p>DASHI Shumë persona do të paguanin për të qenë në kushtet në të cilat gjendeni ju momentalisht. Nuk po e vlerësoni siç duhet atë çka ju ofrohet.</p>	 <p>DEMI Ka ardhur momenti që ju të merrni vendime lidhur me jetën sentimentale. Nuk mund të shtyni pafund një situatë që ka nevojë për zgjidhje.</p>	 <p>BINJAKËT Ndihehi më të mbushur sot nga shumë objektiva që keni mundur të realizoni. Kjo ka ndikuar edhe në gjendjen tuaj shpirtërore duke ju bërë më gazmor.</p>	 <p>GAFORRJA Tashmë ajo që po bëni nuk është më çështje fati. Jeni ju që me ambicien tuaj keni arritur të qani edhe aty ku ka qenë e pamundur.</p>	 <p>LUANI Ka njerëz që duan t'ju udhëheqin drejt përvojave të reja profesionale. Edhe pse jeni pak skeptik, duhet të provoni rritjen në karrierë.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Keni hequr dorë nga rutina juaj dhe po provoni situata të reja që nuk do t'i kishit menduar më parë. Kjo do t'ju bëjë njeri më të mirë.</p>
 <p>PESHORJA Duke nisur që sot, do të ketë të reja në jetën tuaj, që do të ndryshojnë çdo aspekt të saj. Dhe të tjerët janë duke pritur nga ju disa gjëra.</p>	 <p>AKREPI Disa situata të komplikuar do t'ju shkaktojnë jo pak tension sot, por do të arrini të dilni në krye me sukses. Familjarët janë duke përgatitur një surprizë për ju.</p>	 <p>SHIGJETARI Sakrificat tuaja do të shpërblehen sot. Edhe pse mendoni se gjërat nuk po shkojnë siç duhet, po të jeni më optimist, do të shihni se është e kundërta.</p>	 <p>BRICJAPI Mos u mërzisni me ofrimin e disa fakteve që po ju vënë përpara të afërmit tuaj. Do të shikoni që keni besuar tek një person që nuk e meritonte.</p>	 <p>UJORI Duhet të jeni me në brendësi të gjërave që po ndodhin në ambientin tuaj profesional ose akademik. Keni marrë të mirëqena shumë situata që ju kanë thënë.</p>	 <p>PESHQIT Nëse mbani fjalën e dhënë sot, do të jeni mjaft korrekt me ata persona që po bashkëpunoni. Dëshira për pushime ka kohë që ju ka kapluar.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BORDEAUX - ILLICHIVETS MARIUPOL

1

RAPID VIENNA - SLOVAN BRATISLAVA

1

BURNLEY - ISTANBUL

1

Dallku qëndron te Prishtina, vjen edhe Marjo Morina

Fituesja e Kupës në edicionin e fundit, Prishtina, ka vazhduar konsolidimin për kampionatin 2018/2019. Ky klub ka arritur ta mbajë kapitenin Armend Dallku, kurse nga Shqipëria e ka transferuar sulmuesin Marjo Morina që do të jetë zëvendësues i Ahmed Januzit

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 GUSHT - Dy ditë pas humbjes në finalen e Superkupës, Prishtina ka arritur marrëveshje për vazhdimin e kontratës me kapitenin Armend Dallku. Ky i fundit me përvojën që ka në Kombëtaren e Shqipërisë dhe garat evropiane do të jetë lider i "bardhekaltërve" edhe në edicionin e ri futbollistik. "Jam shumë i lumtur që kemi arritur marrëveshje me klubin. Duhet theksuar se ana financiare nuk ka qenë elementi kryesor i marrëveshjes, por disa detaje të tjera. Shpresoj se kjo marrëveshje të jetë në dobi profesionale si për mua ashtu edhe për klubin", ka thënë Dallku për faqen zyrtare të Prishtinës.

Mbrojtësi me përvojë ndërkombëtare është optimist se kryeqytetasit do të paraqiten mirë në edicionin e ri për faktin se tash do të luajnë në stadiumin e tyre "Fadil Vokrri". "Besoj shumë se me njerëzit që janë pjesë e klubit do të bëjmë punë të mirë këtë vit dhe do ta kemi më të lehtë pasi jemi rikthyer në shtëpinë tonë. Tash na mbetet përgjegjësia në lojtarëve që adhuruesve, posaçërisht 'Plisave', t'u dhurojmë kënaqësi me fitore drejt titullit të kampionit", ka shtuar ai. Armend Dallku ka regjistruar 64 paraqitje për Kombëtaren e Shqipërisë dhe ka shënuar një gol, kurse përveç Prishtinës ai ka bërë karrierë të suksesshme edhe në Shqipëri me Elbasanin dhe në Ukrainë me Vorskla Poltavën.

E paqartë vazhdon të jetë e ardhmja e mesfushorit Liridon Fetahaj, i cili ditë më parë për gazetë kishte deklaruar se shumë shpejt do të vendosë së bashku me drejtuesit Klubit të Prishtinës se a do të mbetet pjesë e kësaj skuadre, apo të largohet. "Kontrata ime me skuadrën e Prishtinës është dy vjet të tjera. Ende nuk kemi vendosur asgjë me klubin, por brenda javës do të dihet përfundimisht



se do të mbetem pjesë e Prishtinës apo të largohem", kishte deklaruar Fetahaj. Ish-lojtari i Lirisë së Prizrenit nuk u aktivizua asnjë minutë në finalen e Superkupës që Prishtina e humbi ndaj Dritës (2-1). Nga Prishtina është larguar sulmuesi Ahmed Januzi dhe kryeqytetasit kanë angazhuar në vend të tij sul-

muesin shqiptar Marjo Morina, i cili është 25-vjeçar. Morina në karrierën e vet ka luajtur për Tiranën, Skënderbeun, Flamurtarin, Kukësin, Kamzën, Besën e Kavajës dhe Dinamon e Tiranës. Ai ka thënë se dëshiron të fitojë tituj me Prishtinën, por ta rikthejë edhe formën që e kishte në të kaluarën.

Federeri: Nuk e di nëse do të luaj në 'Tokio 2020'

CYRH, 15 GUSHT - Tenisti Roger Federer mund të tërhiqet nga sporti më herët se të zhvillohet Olimpiada e vitit 2020 në Tokio. Këtë gjë e ka konfirmuar vetë tenisti zviceran që nga Sinsinati, ku po merr pjesë në turneun Masters, ka konfirmuar se mund të mos jetë në Lojërat e ardhshme Olimpikë. "Nuk e di nëse do të jem ende duke luajtur

deri në atë periudhë. Bëhet fjalë pas dy vjetësh, ndërkohë që unë nuk mund të parashikoj të ardhmen time sportive deri atëherë", ka thënë Federeri, i cili nuk ka më ndërmend të luajë me kombëtaren zvicerane në Kupën Davis, turne që i jep mundësi të luajë në Olimpiadë dhe në këtë ngjarje mund të marrë pjesë vetëm me ftesë.

"Rëndësi për mua kanë shëndeti dhe karriera dhe nuk mund të programoj që tani kalendarin tim të garave. Nëse do të kem mundësi do të luaj, në të kundërtën jo. Kjo nuk është Olimpiada e parë që marr pjesë", ka deklaruar Federeri, fitues i të Artës në "Pekin 2008" në lojën dyshe bashkë me Stanislas Wawrinka.

SHKURT

Sejdiu, trajner i Trepçës

Skuadra e Trepçës në futboll e ka angazhuar ish-lojtarin, Isuf Sejdiun, në pozitën e trajnerit të juniorëve. "Me informatat të cilat i janë ofruar klubit për punën e mirë që ka bërë ish-lojtari ynë me grupmoshat e reja, arritëm marrëveshje për ta angazhuar trajner të juniorëve. Trajnerit të ri i urojmë mirëseardhje dhe suksese në të ardhmen", thuhet në njoftimin e Trepçës. Ndryshe, Isuf Sejdiu është djali i trajnerit të njohur dhe të suksesshëm në Kosovë, Gani Sejdiut.

Arbnor Muja transferohet në Gjermani

Talenti Arbnor Muja ka njoftuar se karrierën e futbollit do ta vazhdojë në Gjermani. Sulmuesi 19-vjeçar nëpërmjet "Facebook" -ut ka njoftuar se ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me skuadrën Eintracht Braunschweig të ligës së tretë gjermane, duke u larguar nga Trepça '89. Muja ka falënderuar ish-skuadrat Bardhi, Trepça dhe Trepça '89 për përkrahjen në karrierë.

Ademi: Fishekzjarrët nuk do të ndikojnë në vlerësimin e UEFA-s

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, në një intervistë për "Promenadë Vere" ka folur edhe për hedhjen e mjeteve piroteknike nga tifozët e Dritës. Sipas tij, kjo gjë mund të potencohet në raport, por vetëm do të raportohet për sjelljen e tifozëve. "Pavarësisht se janë të ndalueshme, shpesh tifozët i fusin ato brenda. Nuk besoj se kjo do të ndikojë në vlerësimin e aspektit taktik të UEFA-s", ka thënë Ademi.

Osmani: Shkëndija synon fazën e grupeve në Ligën e Evropës

Skuadra e Shkëndijës nga Tetova është eliminuar nga Liga e Kampionëve, por tash do të luajë në Ligën e Evropës. Shkëndija në ndeshjen kthyesë pësoi humbje 0-1 nga Red Bull Salzburgu, kurse trajneri Qatip Osmani ka lavdëruar lojën e skuadrës së tij, kurse bëri me dije se synon fazën e grupeve në Ligën e Evropës. "Në 'play-off' të Ligës së Evropës me shumë gjasa do të përballemi me Rosenborgun. Bëhet fjalë për skuadër kualitative e cila kohët e fundit nuk është në nivelin e dikurshëm dhe mendoj se në këtë moment ne mund t'i kërkojmë shanset tona për hyrje në fazën e grupeve", ka thënë Osmani.

Në shtator ndeshje miqësore të Kombëtares U-17 në Shqipëri, U-16 në Luksemburg

PRISHTINË, 15 GUSHT - Muaji shtator do të jetë i ngarkuar me ndeshje miqësore të ekipeve përfaqësuese të Kosovës. Drejtori për marrëdhënie me jashtë dhe i ekipeve përfaqësuese, Artan Govori, ka bërë me dije se gjatë muajit

shtator, krahas ndeshjeve kualifikuese të Përfaqësueses A dhe U-21, ndeshje miqësore do të zhvillojë edhe Përfaqësuesja U-17, e cila më 9 dhe 11 shtator në stadiumin "Loro Boriçi" në Shkodër, do t'i zhvillojë dy ndeshje me

kombëtaren e Shqipërisë. Po ashtu, edhe grupmosha U-16 do të udhëtojë nga 3 deri më 7 shtator për në Luksemburg, ku më 4 dhe 6 shtator do t'i zhvillojë dy ndeshje me këtë grupmoshë. Kjo po bëhet në kuadër të planprogrameve

zhvillimore të ekipeve përfaqësuese, thuhet në njoftimin e FFK-së. Më 30 gusht dhe më 2 shtator Përfaqësuesja A e femrave do të zhvillojë dy ndeshje me përfaqësuesen maqedonase në Maqedoni.



BMW-ja në sulm për aksionet e Audisë te Bayerni



MUNCHEN, 15 GUSHT - "Lufta" për futbollin duket se do ta përfshijë edhe botën automobilistike, më konkretisht kompanitë e njohura gjermane të prodhimit të makinave, BMW dhe Audi. Sipas së përditshmes gjermane "Bild", drejtuesit e BMW-së kërkojnë t'i blejnë kuotat e aksioneve që ka Audi te Bayern Munchen, që është klubi më i rëndësishëm i Gjermanisë dhe një ndër më të mëdhenjtë në Evropë. Gjithnjë sipas së përditshmes "Bild", BMW-

ja kërkon t'i blejë kuotat prej 8.33 % të aksioneve të Audit në klubin "bavarez", për një vlerë që e kalon shifrën e 100 milionë eurove. Vetë drejtuesit e kampionëve të Gjermanisë e shohin me sy të mirë këtë transaksion, që do të thotë një ndarje me Audin, pjesë e grupit Volkswagen, të përfshirë vitet e fundit në skandalin e madh "Dieselgate" që solli edhe arrestimin e ish-presidentit të tij. Pronësia e Bayernit është e ndarë në këtë mënyrë: 75 % e aksioneve

janë në zotërim të klubit, ndërsa tri nëndarje kuotash prej 8.33 % janë në zotërim të sponsorëve kryesorë të Bayernit. "Allianz" që i ka dhënë edhe emrin stadiumit, "Adidas", që furnizon skuadrën me veshjet sportive; si dhe Audi, marka zyrtare e makinave të Bayernit. BMW-ja kërkon të jetë pjesë e klubit në vend të Audit, por problemi qëndron pikërisht te Volkswageni, që duket se nuk do t'ia lehtësojë gjërat BMW-së për kryerjen e këtij transaksioni.

Collina: VAR-i, e ardhmja e futbollit

ROMË, 15 GUSHT - Pavarësisht prej kundërshtimeve, që nuk mund të mungonin, përfshirja e teknologjisë në futboll ka pasur ndikim mjaft pozitiv. Kjo u konfirmua edhe në edicionin e fundit të Kupës së Botës, ku gabimet u minimizuan. Ish-disenjatori i gjyqtarëve pranë UEFA-s, Pierluigi Collina, foli rreth sistemit VAR, duke vlerësuar ndryshimet pozitive në marrjen e vendimeve. Një nga temat më të diskutuara është nëse ky sistem do të përdoret edhe në Ligën e Kampionëve, me ish-gjyqtarin e famshëm që analizoi vështirësitë. "FIFA besoi menjëherë te ky projekt dhe i nisi përgatitjet shumë më përpara kohe. Përdorimi i VAR-it në Ligën e Kampionëve ka disa problematika, sepse deri më tani sistemi është shfrytëzuar vetëm në liga të vendeve të caktuara. Ta përdorësh në Ligën e Kampionëve do të thotë më shumë vende dhe më tepër transmetues dhe kjo e komplikon



situatën", ka deklaruar Collina. "Megjithatë, jam i sigurt se UEFA do të vendosë ta implementojë dhe kur kjo të ndodhë, gjyqtarët do të jenë gati. Nuk e shoh të ardhmen pa sistemin VAR, sepse gjithçka që bëjmë në ditët e sotme bazohet te

përdorimi i teknologjisë. Edhe vetë ky sistem përmirësohet, madje para Botërorit kaluam në vizualizimin e pozicionit jashtë lojës në 3D, për t'i vlerësuar situatat me saktësi maksimale", përfundoi ish-gjyqtari italian.

SHKURT

"L'Equipe": Zidane zëvendëson Mourinon në United

Zinedine Zidane mund të jetë pasardhës i Jose Mourinhos në stolin e Manchester Unitedit. E përditshmja prestigjioze sportive "L'Equipe" raporton për mundësinë e kalimit të trajnerit francez në "Old Trafford". Sipas mediumit francez, Unitedi është gati ta shkarkojë portugezin Mourinho dhe në vend të tij ta emërojë ish-trajnerin e Real Madridit.

City në "alarm", lëndohet De Bruyne

Një nga lojtarët më të mirë në Manchester City, Kevin De Bruyne, ka pësuar një lëndim serioz në ligamentin e gjurit. Tifo grupi i respektuar City Watch ka zbuluar se belgu mund të qëndrojë për muaj të tërë larg fushave me një dëmtim të njëjtë me atë të pësuar dy vjet më parë. Atë vit De Bruyne qëndroi mbi dy muaj larg fushave dhe tani mund të përsëritet i njëjti skenar. Gjatë janarit të 2016-s, ylli i Belgjikës është larguar me barelë nga fusha gjatë fitores së Ligës së Kupës ndaj Evertonit.

N'Zonzi prezantohet te Roma

Kampioni i botës me Francën, Steven N'Zonzi, edhe zyrtarisht është lojtar i Romës. N'Zonzi ishte kërkuar nga disa skuadra të mëdha evropiane, përfshirë edhe Arsenalin, por në fund vendosi t'i bashkohet Romës. Mesfushori N'Zonzi i ka kushtuar skuadrës italiane 30 milionë euro.

Sandro nuk largohet nga Juventus

Alex Sandro pritet të qëndrojë te Juventus. Pas interesimit të vazhdueshëm gjatë kësaj merkatoje, nga ana e Paris Saint Germainit, vetë francezët i ofruan "Zonjës së Vjetër" 60 milionë euro për kartonin e lojtarit. Por, kjo ofertë u refuzua menjëherë nga skuadra italiane, e cila e konsideron brazilianin lojtar kyç për të ardhmen. Madje, meqenëse kontrata i skadon në vitin 2020, drejtuesit bardhezinj duan t'i rinovojnë kontratën mbrojtësit të majtë, me agjentët e këtij të fundit të cilët kërkojnë një rrogë prej 4.5 milionë eurosh në sezon.

Presidenti i Barcelonës: Dua që ky vit të jetë historik për ne

Presidenti i Barcelonës, Josep Maria Bartomeu, është shprehur shumë ambicioz dhe ka thënë se këtë sezon, klubi i tij synon t'i fitojë të gjitha trofetë e mundshëm. "Ne po hyjmë në sezonin e ri shumë të emocionuar dhe me pritshmëri të larta. Gjëja e parë që dua të bëj është ta theksoj vlerën e asaj që bëjmë në vitin e kaluar, kur fituam La Ligën për të shtatën herë në dhjetë vjet", ka thënë Bartomeu. "Tani duhet të fitojmë gjithçka këtë sezon, të arrijmë të gjitha finalat dhe t'i fitojmë ato. Filluam me Superkupën e Spanjës, e cila ishte një fitore e merituar kundër një skuadre të mirë. Ajo e bëri Lionel Messin lojtarin me më së shumti trofe në historinë e Barcelonës. Ne duam të fitojmë gjithçka dhe jo vetëm në futboll, por në të gjitha sportet në të cilat garojmë. Dua që ky vit të jetë historik për ne. Kemi filluar me fitore dhe shpresoj se do ta përfundojmë mirë", ka deklaruar Bartomeu.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr. 471/2018
Dt: 15.08.2018

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenit 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, të UA të MASHT 10/2018 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Skenderaj, shpall:

Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës në institucionin parashkollor (çerdhen e fëmijëve) "Nëna Zahide"- në fshatin Banjë të komunës së Skenderajt

Konkursi është i hapur për këto pozita:

- 1. Titulli i vendit të punës : Motër Edukatore**
 - Numri i orëve në javë : 40 orë
 - Paga mujore bruto – 349.05 euro
- 2. Titulli i vendit të punës : Zyrtar/e Administrativ/e**
 - Numri i orëve në javë : 40 orë
 - Paga mujore bruto – 399.75 euro
- 3. Titulli i vendit të punës : Edukator/e**
 - Numri i orëve në javë : 20 orë
 - Paga mujore bruto – 393.22 euro
- 4. Titulli i vendit të punës : Edukator/e**
 - Numri i orëve në javë : 20 orë
 - Paga mujore bruto – 393.22 euro
- 5. Titulli i vendit të punës : Punëtor teknik**
 - Numri i orëve në javë : 40 orë
 - Paga mujore bruto – 272.88 euro
- 6. Titulli i vendit të punës : Kuzhinier/e**
 - Numri i orëve në javë : 40 orë
 - Paga mujore bruto – 334.21 euro
- 7. Titulli i vendit të punës : Pastrues/e**
 - Numri i orëve në javë : 40 orë
 - Paga mujore bruto – 272.88

Kushtet: Për pozitat 1, 2, 3 dhe 4 kandidatët duhet të kenë të kryer shkollimin përkatës sipas UA të MASHT nr. 10/2018 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, ndërsa për pozitat 5,6 dhe 7 kandidatët duhet të kenë të kryer shkollën e mesme.

Testi me shkrim për të gjithë kandidatët e konkursit do të mbahet më 03 shtator 2018, prej orës 14⁰⁰ në Qendrën e Kompetencës.

Për Intervistën me gojë do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë, sipas nenit 4 të UA 17/2009.

Emrat e kandidatëve dhe orari i intervistës do të publikohen në webfaqen e Komunës së Skenderajt <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/category/konkurset-njoftimet/>

Për konkurrim, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin :

- ❖ Diploma dhe një kopje e vërtetuar e diplomës;
- ❖ Kopja e letërnjoftimit;
- ❖ Vërtetimin për punë nga gjykata;
- ❖ Certifikatën e gjendjes shëndetësore (në rast se pranoheni);
- ❖ Certifikatë trajnimi - nëse keni ;
- ❖ Përvoja e punës - nëse keni ;
- ❖ Referencën e punës – ata që kanë përvojë pune;
- ❖ Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati përshesë, sporteli nr. 13;

Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuar nga MASHT.

Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim. Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt me datë 06.09.2018.

Dokumentacioni nuk kthehet.

Afati i konkursit mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë dhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Drejtoria Komunale e Arsimit
Skenderaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim/Direkcija za Obrazovanje/ Department of Education

Br. 471/2018 god.
Dt. 15.08.2018 god.

Na osnovu člana 8 Zakona o Radu br. 03/L-212, člana 17, slovo h) Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L-040, AU br. 07/2017 za reguliranje postupaka konkursa u javnom sektoru, AU MONT-a br. 10/2018 za pravila o stručnom kadru u opštem obrazovanju, Opštinska Direkcija za Obrazovanje u Skenderaj/Srbici, objavljuje sledeći:

Konkurs za popunjavanje slobodnih radnih mesta u predškolskoj instituciji (dečije obadnište) „Nëna Zahide“ u selo Banje opštine Skenderaj/Srbica

Konkurs se objavlja za sledeće položaje:

- 1. Naziv radnog mesta: Sestra Vaspitačica**
 - Broj časova nedeljno: 40 časova
 - Mesečna plata bruto: 349.05 eura
- 2. Naziv radnog mesta: Administrativni/a službenik/ca**
 - Broj časova nedeljno: 40 časova
 - Mesečna plata bruto: 399.75 eura
- 3. Naziv radnog mesta: Vaspitač/ica**
 - Broj časova nedeljno: 40 časova
 - Mesečna plata bruto: 393.22 eura
- 4. Naziv radnog mesta: Vaspitač/ica**
 - Broj časova nedeljno: 40 časova
 - Mesečna plata bruto: 393.22 eura
- 5. Naziv radnog mesta: Tehnički Radnik**
 - Broj časova nedeljno: 40 časova
 - Mesečna plata bruto: 272.88 eura
- 6. Naziv radnog mesta: Kuvar/ica**
 - Broj časova nedeljno: 40 časova
 - Mesečna plata bruto: 334.21 eura
- 7. Naziv radnog mesta: Čistač/ica**
 - Broj časova nedeljno: 40 časova
 - Mesečna plata bruto: 272.88 eura

Uslovi za položaje 1,2,3 i 4, kandidati moraju imati dotično školovanje po AU-a MONT-a br. 10/2018 za pravila stručnog kadra u opštem obrazovanju, a za položaje 5,6 i 7, kandidati moraju imati završenu srednju školu.

Pismeni tekst za sve kandidate ovog konkursa će se održati datum 03 septembra 2018 godine, počev od 14,00 časova u Centru Kompetencije (zanatstva) u Skenderaj/Srbici.

Po usmeno intervjuu će se pozvati kandidati uže liste, po članu 4 AU-a br. 17/2009 godine.

Imena kandidata i vreme intervjuu će se objaviti u ueb stranicu opštine Skenderaj/Srbica <https://kk.rks-gov.net/skendeaj/kategorija/konkursi-obaveštenja/>.

Za konkursianje kandidati moraju popuniti sledeću dokumentaciju:

- ❖ Diploma i jedno overeno kopije diplome;
- ❖ Kopije lične karte;
- ❖ Potvrdu za rad od Suda;
- ❖ Uverenje o zdravstvenom stanju (u slučaju kada ste primljeni);
- ❖ Uverenja za trajninge – ako imate;
- ❖ Radno iskustvo – ako imate;
- ❖ Referencu rada – za one koje imaju radno iskustvo;
- ❖ Aplikacije možete naći i predati u objektu opštine, prizemni sprat, šalter br. 13.

Kandidati koji su diplomirali van Republike Kosova, moraju imati nostrifikovane diplome od MONT-a.

Nekompletirana dokumentacija i ona koja dolazi posle roka konkursa, neće se razmatrati. Rezultate konkursa će se objaviti u ueb stranicu opštine Skenderaj/Srbica datum 06.09.2018 godine, predata dokumentacija ne vraća se.

Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja ovog istog u dnevnoj novini i službeni ueb stranicu opštine Skenderaj/Srbica.

Opštinska Direkcija za Obrazovanje
Skenderaj/Srbica.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 16 gusht 2018

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të nenit 17 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; si dhe në mbështetje të Rregullores për stazhin e praktikantëve në Gjykatën Kushtetuese, Nr. 04/12; me qëllim të edukimit profesional në fushën juridike të gjykimit dhe të interpretimit kushtetues, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës shpall publikisht

SHPREHJEN E INTERESIT për angazhimin e praktikantëve

1.
Pozita: Praktikant
Numri i pozitave: 8 (tetë)
Kohëzgjatja e punës: 3 muaj

Detyrat kryesore

Praktikanti kryen punë në Gjykatë sipas kushteve të parapara me Rregulloren për stazhin e praktikantit në Gjykatën Kushtetuese, Nr. 04/12.

Kualifikimet dhe aftësitë

- Kandidatët për praktikantë duhet të jenë juristë të kualifikuar, me diplomë universitare dhe/ose studentë në vitin përfundimtar të studimeve juridike;
- Kandidatët duhet ta njohin shkëlqyeshëm gjuhën angleze, si dhe të demonstrojnë shkathhtësi solide kompjuterike.

Informata të përgjithshme për kandidatët

Përcaktimi i kompensimit për praktikantë bëhet në përputhje me vendimin e posaçëm të Gjykatës Kushtetuese.

Praktikanti, pas kalimit të afatit kohor për të cilin është pranuar në Gjykatë, i nënshtrohet vlerësimit të njohurive të fituara gjatë punës praktike.

Pas vlerësimit pozitiv nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, praktikanti pajiset me certifikatë me të cilën dëshmohet kryerja e suksesshme e punës praktike në Gjykatë.

Gjykata ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e praktikantëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacioni përkatës për përgatitjet shkollore. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, duhet të paraqitet nëpërmjet e-mailit, në adresën: lulzim.syla@gjk-ks.org

Data e fundit e dorëzimit të aplikacioneve nga kandidatët e interesuar është **30 gusht 2017, në orën 24:00.**

Shënim:

Kërkesat e dërguara pas afatit të përcaktuar për dorëzimin e aplikacioneve, nuk do të pranohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtina, 16 August 2018. god.

U saglasnosti sa članom 12 Zakona o Ustavnom sudu Republike Kosovo, Br. 03/L-121; u saglasnosti sa članom 17 Poslovnika o radu Ustavnog suda Republike Kosovo; kao i u saglasnosti sa Poslovníkom o zapošljavanju pripravnika u Ustavnom sudu, br. 04/12; u cilju profesionalnog obrazovanja u oblasti ustavnog prava i sudskog tumačenja, Sekretarijat Ustavnog suda Republike Kosovo, javno objavljuje

IZRAŽAVANJE INETERESA Za zapošljavanje pripravnika

1.
Mesto: Pripravnik
Broj mesta: 8 (osam)
Trajanje ugovora: 3 meseca

Osnovne dužnosti

Pripravnik obavlja posao u Sudu, u skladu sa uslovima predviđenim Poslovníkom o zapošljavanju pripravnika u Ustavnom sudu, br. 04/12.

Kvalifikacije i veštine

- Kandidat za pripravnika treba da bude diplomirani pravnik, sa univerzitetskom diplomom i/ili student završne godine studija prava
- Kandidat treba da poseduje odlično znanje engleskog jezika, kao i da pokaže solidno poznavanje rada na računaru

Opšte informacije za kandidate

Određivanje naknade za pripravnike vrši se u skladu sa posebnom odlukom Ustavnog suda.

Pripravnik, nakon isteka vremenskog roka, na koji je primljen u Sud, podleže oceni znanja stečenog tokom prakse.

Nakon pozitivne ocene od strane direktnog rukovodioca, pripravnik dobija sertifikat kojim se potvrđuje uspešno obavljena praksa u Sudu.

Sud nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise zapošljavanje praktikanata, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Postupak konkurisanja

Zainteresovani kandidati trebaju podneti odgovarajuću aplikaciju, kojoj prilažu profesionalnu biografiju, motivaciono pismo, kao i dokumentaciju o stručnoj spremi. Aplikacija se može preuzeti sa internet stranice Ustavnog suda: www.gjk-ks.org

Aplikaciju sa ostalim dokumentima, treba predati putem elektronske pošte, na sledeću email adresu: lulzim.syla@gjk-ks.org

Poslednji dan za podnošenje aplikacija zainteresovanih kandidata je **30 Augusta 2018, do 24:00 sati.**

Napomena:

Primljeni zahtevi nakon isteka roka pred viđenog za dostavljanje aplikacija, neće biti prihvaćeni. U slučaju velikog broja primljenih zahteva, biće pozvani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR TENDERË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit: 01-18

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtronë veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetsore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetsore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën Rr. Kosta Novaković, Kontenieri i III, kati i 3-të, zyra nr. 214, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit liridon.beha@omk-rks.org/rina.halilaj@omk-rks.org me titullin: Dosja për: Furnizim me Vula.

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është **24.08.2018 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është **30.08.2018 ora 14:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën **31.08.2018 ora 14:00.**

OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m², dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m².

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.

OFERTE PËR SHITJEN E PATUNDSHMËRISË

Blerim (Nuredin) Berisha, me banim ne fshatin Poslisht K.K. Prizren i pajisur me letërnjoftim - numër personal: 1006612608 të lëshuar nga MPB e Kosovës - Prishtinë, është bashkëpronar me pjesën prej 185/285 e pjesës ideale te patundshmërisë , me numër të Njësia Kadastrale P.nr. 71813067-00566, në vendin e quajtur "Llofka - Llofka ", me kulturë bujqësore arë e kl .4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2851 m², Zona Kadastrale Poslisht.

Nga pjesa e vet ideale i fron për shitje sipërfaqen prej 500 m² të patundshmërisë me të dhënat si me lart, në shumën prej 1.000 € për një ari, përkatësisht në shumën e përgjithshme prej 5.000 €, (me shkronja: Pesë mijë euro) .

Prizren: 15.08.2018

Ofertuesi: Blerim Berisha



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/giejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Belul Muji shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Merdon Amza shpall te pavlefshme dëftesat e kl: 10,11,12 dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

► Lëshoj banesa me qira afër Eulex-it, ish Farmedi, në lagje të spitalit, banesa është e lirë që nga data 01.08.2018. Banesat janë të ndërtuar nga kompania "Cima Contrekshen" njëra banesë ka 112 metër katror ndërsa tjetra 85 metër katror. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 044-923-527 dhe 044-402-679.

► Urgjentisht kërkoj një banës me qera për një person te huaj, Banesa duhet te jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet te ketë dy dhoma gjumi, te jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770

► Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllushi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- llofti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe deponitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

